

DALLIMET JANË VLERË-JO BARRIERË

ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË SË KUADRIT LIGJOR TË KOSOVËS ME KONVENTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

QASJA DHE PJESËMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE

AUTORE

Latife Neziri-Avokate-Avokatura Lexius, Ferizaj

Mbështetur nga HANDIKOS Kosova

Grupi Punues Legjislativ për Qasje

Rukije Gashi, Besim Galica, Besart Ramadani, Bekim Krasniqi, Bedri Kadrija

Grupi Punues Legjislativ për Pjesëmarrje

Mimoza Rrahmani, Musa Shigjeqi, Emira Kuqani, Lirik Krasniqi, Enver Kurtalani, Daut Tishuku

Përkthimi dhe redaktimi: Dukagjin Kelmendi

Dizajni, faqosja, printimi: Metro Print

Botuesit

HANDIKOS – Shoqata e Paraplegjikeve dhe Paralizes së femijeve të Kosovës

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (ADRF)

Polio plus – Movement against Disability,

Shoqata Kombëtare Shqiptare e Personave që nuk Dëgjojnë (ANAD)

handikos@handi-kos.org

<https://handi-kos.org/>

Projekti Aleancat e Aftësisë së Kufizuar për Zhvillimin e Reformave Gjithëpërfshirëse në Rajon (DADIRR),

Mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë

Ky raport u zhvillua me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans – Shoqëria Civile për Shoqërinë e Përbashkët në Ballkanin Perëndimor" të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD), Qendra për Kërkim dhe Krijim Politikash (CRPM) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (MPJN) Publikimi i nënshtrohet të drejtës së autorit. Mund të riprodhohet pa pagesë apo leje paraprake për qëllime të tjera, por jo për rishitje. Për përdorim në çfarëdo rrethane tjetër, leja paraprake me shkrim duhet të merret nga botuesi.

PËRMBAJTJA

AKRONIMET.....	4
PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE.....	5
HYRJA.....	9
METODOLOGJIA.....	12
I.AKTET JURIDIKE QË TRAJTOJNË ÇËSHTJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR	14
1.Kushtetuta e Republikës së Kosovës.....	14
2.Ligji për Personat e Verbër.....	16
3.Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.....	16
4.Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të kufizuar.....	17
5.Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.....	17
6.Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.....	18
7.Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.....	18
8.Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare.....	18
9.Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi	19
10.Rregullore e QRK për Mekanizmat Institucional për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna.....	19
11.Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar.....	19
12.Rregullore e QRK për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës.....	20
13.Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023.....	20
II.KONVENTA NDËRKOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR & REKOMANDIMET E KOMITETIT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR –QASJE DHE PJESËMARRJE	21
Qasja/Qasshmëria.....	23
Pjesëmarrja në jetën publike dhe politike.....	26
III.STRATEGJIA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2021-2030.....	29
IV.OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM DHE AFTËSIA E KUFIZUAR	31
V.KORNIZA LEGJISLATIVE E KOSOVËS PËR QASJEN DHE PJESËMARRJEN NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE..	32
Definicioni i aftësisë së kufizuar	33
Kushtetuta e Republikës së Kosovës për Qasje dhe Pjesëmarrje.....	34
QASJA	35
Mjedisi fizik.....	41
Transporti Publik	42
Informimi dhe komunikimi.....	45
Shërbimet Publike.....	45
PJESËMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE.....	48
Pjesëmarrja në votime dhe pjesëmarrja në zgjedhje.....	20
Përfaqësimi në institucione publike.....	52
Pjesëmarrje në organizata joqeveritare dhe përfaqësimi i organizatave.....	52
Përfaqësimi i personave me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.....	52
VI.KUADRI INSTITUCIONAL PËR QASJE DHE PJESËMARRJE NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE	53
VII. FORMA E PËRMBLEDHUR E ANALIZËS SË KORNIZËS LIGJORE PËR QASJE DHE PJESËMARRJE NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE.....	55
VIII PËRFUNDIME	64
Materiali referues.....	66
V.KORNIZA LEGJISLATIVE E KOSOVËS PËR QASJEN DHE PJESËMARRJEN NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE..	32
Definicioni i aftësisë së kufizuar	33
Kushtetuta e Republikës së Kosovës për Qasje dhe Pjesëmarrje.....	34
QASJA	35
Mjedisi fizik.....	41
Transporti Publik	42

Informimi dhe komunikimi.....	45
Shërbimet Publike.....	45
 PJESËMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE.....	48
Pjesëmarrja në votime dhe pjesëmarrja në zgjedhje.....	50
Përfaqësimi në institucione publike.....	52
Pjesëmarrje në organizata joqeveritare dhe përfaqësimi i organizatave.....	52
Përfaqësimi i personave me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.....	52
 VI.KUADRI INSTITUCIONAL PËR QASJE DHE PJESËMARRJE NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE	53
VII. FORMA E PËRMBLEDHUR E ANALIZËS SË KORNIZËS LIGJORE PËR QASJE DHE PJESËMARRJE NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE.....	55
 VIII PËRFUNDIME	64
Materiali referues.....	66

AKRONIMET

BE - Bashkimi Evropian

GPLQ - Grupi Punues Legjislativ për Qasje

GPLP - Grupi Punues Legjislativ për Pjesëmarrje

HANDIKOS - Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës

KPAK - Këshilli për Personat me Aftësi të Kufizuar

KDPAK - Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

OPAK - Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar

OSHC - Organizatat e Shoqërisë Civile

PAK - Persona me Aftësi të Kufizuar

QZHQ - Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të)

SHKSH - Shoqata Kosovare e të Shurdhërve

SHVK - Shoqata e të Verbërve të Kosovës

TIK - Teknologjia Informacionit dhe Komunikimit

UA - Udhëzimi Administrativ

VV - Vendvotimet

ZQM - Zyra për Qeverisje të Mirë

PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE

- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK), është instrument i detyrueshëm ndërkombëtarë për shtetet të cilat e kanë pranuar dhe ratifikuar me të cilën rregullohen të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. Një nga kërkesat kryesore të Konventës është që shtetet nënshkruese të harmonizojnë legjislacionin e tyre nacional me kërkesat e kësaj Konvente.
- Ky raport ka për qëllim që të prezanton analizën e kornizës ligjore të Kosovës në raport me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, përkatësisht Nenin 9, për qasjen dhe Nenin 29, për pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike. Për qëllim të kësaj analize janë krahasuar kërkesat e nenit 9 dhe 29 të KDPAK me legjislacionin e Kosovës që adreson këto fusha me theks të posaçëm për fushën e qasjes, mjedisin fizik, transportin, informacionin dhe komunikimin dhe shërbimet publike, ndërsa në fushën e pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike, pjesëmarrjen në votime dhe zgjedhje, përfaqësimin në institucione publike, përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuar (PAK) në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale dhe pjesëmarrje në organizata joqeveritare dhe përfaqësim të organizatave. Të dy këto fusha për hulumtim janë vlerësuar edhe nga konteksti i parimeve të mos diskriminimit të garantuar me kushtetutë dhe ligj përkatës ku aftësia e kufizuar është një nga bazat për diskriminim. Një vështrim i shkurtër i është kushtuar edhe kornizës institucionale, përgjegjëse për zbatimin e legjislacionin në nivel nacional dhe lokal.
- Për qëllime të kësaj analize, hulumtimi është bazuar në metodologjinë e përcaktuar nga porositi i raportit dhe metodave tjera të kombinuara nga ekspertiza e grupeve punuese dhe hartuesi i raportit. Meqenëse analiza paralelisht zhvillohet në tre vende pjesëmarrëse në projektin "Aleanca e Aftësisë së Kufizuar për Zhvillimin e Reformave Gjithëpërfshirëse në Rajon" (DADIRR), Kosovës, Maqedoni së së Veriut dhe Shqipërisë, ka për qëllim që rezultatet e analizës të jenë të krahasueshme sipas këtyre dy sektorëve për të gjitha vendet pjesëmarrëse me synim që të krijohet një bazë e unifikuar për përcaktimin e rekomandimeve për përmirësimin e legjislacionit në sektorët e përcaktuar në nivel kombëtar dhe të ndihmojë në zbatimin e aktiviteteve të projektit në nivelin rajonal. Të gjeturat në raport janë rezultat i hulumtimit të legjislacionit vendorë, Konventës me interpretimet e përmbajtjes së neneve të Konventës, raportet e Komiteteve përkatëse në kuadër të Konventës, raportet dhe analizat e organizatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, intervistat dhe konsultimet formale dhe joformale me organizatat e personave me aftësi të kufizuar dhe rezultatit të punës së dy (2) grupeve punuese (grupi punues legjislativ për qasje dhe grupi punues legjislativ për pjesëmarrje) së bashku me intervenimin e personave me aftësi të kufizuar dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile për hartimin e Draft Analizës së Kuadrit Ligjor në Kosovë për fushën e qasjes dhe pjesëmarrjes dhe rekomandimeve për intervenim.
- Hulumtimi ka identifikuar infrastrukturën ligjore aktuale (legjislacionin dhe institucionet) në fuqi në Kosovë, përfshirë Kushtetutën e Kosovës si akti më i lartë politik dhe juridik, e i cili i ka adresuar çështjet e aftësisë së kufizuar në fushën përkatëse të këtij hulumtimi.

Këto akte juridike, janë vlerësuar në raport me KDPAK, nenin 9 dhe 29 të Konventës të cilët i referohen qasjes dhe pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike dhe në raport me kërkesat e Komitetit të OKB -se për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të cilët i kanë materializuar këto fusha në kuadër të Konventës. Në referencë të qasjes, neni 9 i Konventës dhe Komiteti i OKB -se përveç tjerash ka përfshirë: jetesa e pavarur; pjesëmarrja e plotë në të gjitha aspektet e jetës; qasje e barabartë në mjedisin fizik; qasje e barabartë në transport; qasje e barabartë në informacion dhe komunikim, duke përfshirë teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit; qasje e barabartë në objektet dhe shërbimet e tjera të hapura ose të ofruara për publikun si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. Ndërsa, në referencë të pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike janë përfshirë por pa u kufizuar në të drejtën për të marrë pjesë në votime, për të marrë pjesë aktive në procesin zgjedhur dhe për të qenë kandidat për tu zgjedhur, të drejtën për të mbajtur poste dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes, të drejtën për pjesëmarrje në organizata joqeveritare dhe të përfaqësimit të organizatës, përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.

- Në kërkesat e nenit 9 dhe 29 të Konventës, një rishikim i shkurtër është bërë edhe në Strategjinë e BE-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021 -2030 - Unioni për Barazi dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm që adresojnë aftësinë e kufizuar me qëllim të mbështetjes së nevojës për intervenim në harmonizimin e legjislacionit.
- Dispozitat ligjore të cilat janë analizuar në krahasim me fushat përkatëse të Konventës për këtë hulumtim përfshijnë: *Kushtetutën e Republikës së Kosovës; Ligjin për Personat e Verbër; Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik; Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara; Ligji për Skemat e Pensionit të Financuara nga Shteti; Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme; Ligji për Zgjedhjet Lokale; Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare; Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara; Rregulloren e QRK Nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës. Këto akte ligjore e kanë trajtuar në mënyrë të veçantë aftësinë e kufizuar të bazuar në llojin e aftësisë së kufizuar (dëmtimet fizike, dëmtimet shqisore, dëmtimet intelektuale etj.). Aftësinë e kufizuar e kanë trajtuar edhe ligje dhe akte të tjera specifike, dispozita ligjore për persona me aftësi të kufizuara ka edhe në ligjet e përgjithshme për fusha të ndryshme, të cilat nuk janë analizuar për këtë hulumtim. Gjithashtu, dokumente të politikave për aftësinë e kufizuar siç është *Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, Plani i Veprimtimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës (2021 -2023)*, por meqenëse ky është viti i fundit për zbatimin e këtyre dokumenteve, ato nuk janë vlerësuar për qëllim të këtij hulumtimi.*
- Legjislacioni aktual në Kosovë nuk është në harmoni me Konventën e KB, përkatësisht me kërkesat e nenit 9 dhe 29 të Konventës dhe Rekomandimeve të Komitetit të OKB -e për personat me aftësi të kufizuara në këto fusha specifike. Me gjithë garancitë që ofron Kushtetuta, kjo situatë qëndron për faktin se mungojnë shumë dispozita ligjore të cilat

do ti adresonin fushat në tërësi. Dispozitat ligjore që ekzistojnë nuk janë në kundërshtim me kërkesat në këto fusha, megjithatë meqenëse mungon adresimi i tërësishëm i fushave specifike, përfundojmë se ka nevojë për rishikim të tërësishëm të kornizës legjislative aktuale dhe hartim të kornizës së re ligjore për aftësinë e kufizuar dhe harmonizim me KDKPAK. Fusha e shtrirjes së kërkesave sipas Konventës është e gjerë, e tërë sfera publike dhe jo vetëm, e gjithë sfera në të cilën ofrohen shërbimet për publikun, që do të thotë edhe ajo private e cila është në funksion të ofrimit të shërbimeve publike, në të gjitha zonat urbane dhe rurale, përfshirja dhe konsultimet me personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat që përbehen prej personave me aftësi të kufizuar në çështjet me interes publik dhe posaçërisht në çështjet që lidhen me aftësinë e kufizuar, etj.

- *Qasja/ qasshmëria*, si një nga parakushtet themelore që personat me aftësi të kufizuar të mund të gëzojnë dhe realizojnë të drejtat e tyre të garantuara me Konventë nuk është adresuar në mënyrë eksplicite në aktet ligjore në Kosovë. Ndërsa, komponentë të qasjes si mjedisi fizik, transporti, informimi dhe komunikimi dhe komponentë të shërbimeve publike janë përfshirë. Megjithatë, asnjë nga komponentët e qasjes që përfshin zonat urbane dhe rurale nuk janë adresuar në mënyrë të plotë. Dispozita ligjore për këto çështje janë: *të shpërndara* në disa akte ligjore primare dhe sekondare, p.sh. dispozita për infrastrukturën gjenden në ligje të veçanta dhe në akte tjera ligjore; janë *të fragmentuara*, sepse pjesë të komponentëve të qasjes gjenden në një apo më shumë akte të shpërndara në disa dispozita, p.sh. shërbimet publike janë të shpërndara dhe të pa definuar; janë *të pa plota* sepse në të gjitha dispozitat është trajtuar një institut por nuk janë trajtuar institute të tjera që e mundësojnë realizimin e plotë të një komponenti, p.sh. gjejmë lirime në udhëtim në mjetet e transportit publik por nuk ka dispozita se si të mund të shfrytëzohet ky përfitim sepse personat me dëmtime fizike për shkak të barrierave fizike në rrugë dhe autobus nuk mund ti përdorin ato. Pastaj, komponentë të qasjes që nuk janë adresuar fare në asnjë pjesë legjislacioni, p.sh. mjetet e dizajnit universal, etj. Gjendja faktike rezulton të jetë edhe më e rëndë nëse do të kishim analizuar zbatimin e këtyre dispozitave sepse PAK dhe OPAK -ët deklarojnë se në disa raste zbatohen dhe në disa raste jo. Zbatim i kryesisht ndodhë në Prishtinë ose diku edhe në zonat tjera urbane, ndërsa në zonat rurale as që bëhet fjalë.
- Dispozitat ligjore që adresojnë *Pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike* janë më të përqendruara dhe me të përmbledhura. Por ky konstatim vlen vetëm për komponentin e pjesëmarrjes në votim për personat me aftësi të kufizuara meqenëse ligji për zgjedhjet e përgjithshme e ka adresuar në mënyrë specifike votimin e personave me aftësi të kufizuar dhe ka dhënë zgjidhje për procedurat përfshirë informimin dhe komunikimin. Gjithsesi, OPAK-ët që përfaqësojnë grupe të ndryshme të aftësisë së kufizuar konstatojnë se megjithatë ende nuk janë zbatuar në tërësi ato dispozita sepse në një numër të madh të vendvotimeve nuk ka qasje fizike për përdorues të karrocave për shkak të barrierave ose për shkak se vendvotimi është në katet e sipërme ku nuk ka qasje përmes ashensorit ose mjeteve të tjera ndërsa situata edhe më dobët qëndron në pjesën e të drejtës për tu zgjedhur sepse nuk ka ndonjë dispozitë ligjore që përcakton kërkesën për një numër të caktuar të përfaqësuesve të PAK-ve. Ndërsa, pjesa tjetër e

kësaj fushe si përfaqësimi në institucione publike, përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale edhe pse nuk është e kufizuar në kuptim të përgjithshëm është adresuar pak ose fare në dispozitat ligjore të këtyre ligjeve ose ndonjë ligji tjetër ndaj edhe pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuar që lidhet me këto komponentë është e ulët dhe vetëm simbolike. Përfaqësimi më adekuat në nivel institucional qendror pasqyrohet vetëm në KPAK që udhëhiqet në nivel të pozitës së zëvendës Kryeministrit dhe administrohet nga ZQM si dhe në nivel lokal në Komitete Konsultative që veprojnë vetëm në një numër të kufizuar të Komunave. Liria e asociimit e garantuar edhe me Kushtetutë shprehimisht është trajtuar në përgjithësi pa e përcaktuar aftësinë e kufizuar për të cilën ka nevojë një dispozitë e veçantë që e përcakton statusin e OPAK -ve.

- Kuadri institucional, përgjegjës për garantimin e sigurimit dhe respektimit të qasjes dhe pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike është i shpërndarë në sektorë të ndryshëm institucional në formën e përgjegjësive për zbatimin e kornizës ligjore pronare të së cilës janë ato institucione. Një rishikim i këtij kuadri në funksion të monitorimit dhe zbatimit të të drejtave që burojnë nga Konventa është i domosdoshëm. Krijimi i mekanizmave në nivel lokal dhe nacional është edhe kërkesë e detyrueshme e KDPAK.
- Raporti do t'ju shërben institucioneve të Kosovës si udhërrëfyes për adresimin e plotë të çështjeve të aftësisë së kufizuar në hartimin e politikave dhe legjisllacionit adekuat, meqenëse ka boshllëqe të mëdha ligjore në këto çështje në përgjithësi dhe posaçërisht në fushat në shënjestër të këtij hulumtimi. Harmonizimi i legjisllacionit të Kosovës me KDPAK është detyrim i obligueshëm për Kosovën, meqenëse këtë vit, me 01 Gusht 2023, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka miratuar përfshirjen e KDPAK në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës, dhe për këtë, pas miratimit në parlamentin e Kosovës si pjesë e këtij neni, Konventa do të jetë e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë dhe do të ketë epërsi ndaj dispozitave ligjore në Kosovë.
- Raporti gjithashtu do t'ju shërbejë organizatave të personave me aftësi të kufizuar dhe vetë personave me aftësi të kufizuar të avokojnë tek institucionet publike në nivel nacional dhe lokal, përfshirë ato ligjvënëse dhe të administratës për adresimin e çështjeve fundamentale në mënyrë që kjo pjesë e shoqërisë të mund të gëzojë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KDPAK në mënyrë të barabartë me të tjerët.
- Ky raport dhe raportet e tjera, në të ardhmen në kuadër të kërkesave të KDPAK-ut duhet të përdoret për të adresuar çështjet e aftësisë së kufizuar me qëllim që në procesin e harmonizimit të infrastrukturës ligjore të Kosovës me kuadrin e të drejtave të garantuara nga Konventa të garantojnë një përputhshmëri e cila u siguron standardet e kërkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
- Raporti e përmban formën e përmbledhur të Analizës së Kornizës Ligjore të Kosovës në referencë të qasjes dhe pjesëmarrjes në të cilën është përfshirë legjisllacioni i Kosovës që ka nevojë për rishikim dhe plotësim, pastaj nevoja për legjisllacion të ri dhe akte tjera që e adresojnë qasjen dhe pjesëmarrjen edhe në nivelin teknik.
- Megjithatë, një raport i veçantë me rekomandime specifike do të përgatitet dhe prezantohet si vazhdimësi e këtij raporti në muajt në vijim.

HYRJE

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK) dhe Protokollin e saj, të cilat janë në fuqi nga viti 2008, janë rezultat i një përpjekje të gjithmbarshme të personave me aftësi të kufizuar në mbarë botën për respektimin e të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët. Përmes kësaj Konvente përçohet mesazhi kryesor se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për të gjithë spektrin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut pa diskriminim¹.

Kjo Konventë është e rëndësishme për personat me aftësi të kufizuar në mbarë botën për shumë arsye, së pari sepse deri më tani Konventa është ratifikuar nga 186 shtete, nënshkruar nga 164, ndërsa protokollin e saj u mundëson personave me aftësi të kufizuar qoftë në mënyrë individuale apo grupe të paraqesin pretendime për shkelje tek Komiteti, është ratifikuar nga 104 shtete dhe nënshkruar nga 94². Së dyti, sepse Konventa i përcakton të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe përgjegjësinë për respektimin e tyre. Së treti, Konventa vë theksin tek barrierat e jo tek personat dhe së fundi, Konventa i sfidon perceptimet se aftësia e kufizuar është problem mjekësorë duke e vënë theksin në qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut³.

Kosova, duke mos qenë shtet anëtarë i OKB-së, formalisht nuk ka mundësi që të aderohet dhe ratifikohet Konventa. Pas një përpjekje disa vjeçare të avokimit dhe lobimit të organizatës HANDIKOS në bashkëpunim edhe me organizata tjera të personave me aftësi të kufizuar, me datë 01 Gusht të vitit 2023, Gjykata Kushtetuese e Kosovës duke e vendosur si të pranueshme kërkesën e parashtruar nga Kuvendi i Kosovës⁴ ka miratuar përfshirjen e KDPAK në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës, dhe me këtë, pas miratimit në Parlamentin e Kosovës, si pjesë e këtij neni Konventa do të jetë e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë dhe do të ketë epërsi ndaj dispozitave ligjore në Kosovë.

Kosova, gjatë viteve të pas luftës dhe ekzistencës si shtet ka hartuar dhe fuqizuar legjislacion për aftësinë e kufizuar. Legjislacioni kryesisht i ka trajtuar personat me aftësi të kufizuar duke u bazuar në llojin e aftësisë së kufizuar⁵ dhe brenda llojit janë garantuar disa nga të drejtat dhe përfitimet për personat me aftësi të kufizuar. Gjithsesi, organizatat e personave me aftësi të kufizuar konstatojnë se ky legjislacion as për së afërmi nuk i trajton aspektet kryesore për personat me aftësi të kufizuar duke përfshirë edhe rastet kur garantohen me anë të ligjit ku zbatimi i dispozitave është i pjesshëm ose fare nuk zbatohet. Në krahasim me standardet e kërkuara të KDPAK konsiderohet se më pak se një e treta (30.72%) e detyrimeve (standardeve) të vlerësuara ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar

¹ UN/ UN Human Rights Office of the High Commissioner THE CONVENTION ON THE RIGHTS OF PERSONS WITH DISABILITIES/ Training Guide/ Professional Training Series/MODULE 2 – A SHORT INTRODUCTION TO THE CONVENTION https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/CRPD_TrainingGuide_PTS19_EN_Accessible.pdf, f.4.

² <https://social.desa.un.org/issues/disability/crpd/convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities-crpd#Fulltext>

³ Si në index 1.

⁴ Gjykata Kushtetuese e Kosovës/ Njoftim për vendim në rastin KO 207/22, 01 Gusht 2023/ <https://qjk-ks.org/njoftim-per-vendim-ne-rastin-ko-207-22/>.

⁵ Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike men dore, intelektuale apo shqisore.

janë të përfshira plotësisht në legjislacionin e Kosovës⁶, ndërsa sa i përket zbatimit, situata është edhe më e cenueshme. Në fund të vitit 2021, me vendimin e Qeverisë⁷, viti 2022 ishte shpallur Vit i Personave me Aftësi të Kufizuara. Megjithatë gjatë vitit 2022 janë parë një varg përpjekjesh për avancimin e pozitës së personave me aftësi të kufizuara, gjendja lidhur me këtë komunitet ka mbetur nën nivelin e standardeve minimale. Dispozitat ligjore lidhur me fusha të ndryshme për adresimin e çështjeve për personat me aftësi të kufizuara janë të pjesshme, të shpërndara, të fragmentuara, të pa materializuara dhe mungojnë shumë çështje të cilat kanë mbetur të pa adresuara ose janë adresuar në mënyrë të përgjithshme por që nuk kanë arritur të zbatohen në praktikë.

Analiza e Kornizës Ligjore të Kosovës në raport me K DPAK dhe rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është e fokusuar në dy sektorë fundamental, atë të qasjes dhe pjesëmarrjes publike dhe politike. Është një përpjekje për të analizuar se sa legjislacioni i aplikueshmen në Kosovë i ka trajtuar këto çështje fundamentale dhe se sa është në harmoni me këto dokumente me qëllim që në fund të analizës të ofrohen rekomandime për ndërhyrje në legjislacion me qëllim që të krijohen standardet minimale të kërkuara dhe harmonizimi me kërkesat e K DPAK.

Duke konsideruar se pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, së shpejti K DPAK do të jetë pjesë e legjislacionit në Kosovë, raporti synon që të prezantojë disa rekomandime për ndërhyrje në sektorët e shënjestruar, pavarësisht se pas amendamentit të nenit 22 të Kushtetutës i tërë legjislacioni që adreson aftësinë e kufizuara do të duhej të rishikohej.

Për arsye të kufizimeve, raporti kufizohet vetëm në analizën e legjislacionit të aplikuar në raport me dokumentet e kërkuara dhe nuk e vlerëson edhe kufijtë e zbatimit të atij legjislacioni.

Organizata Botërore e Shëndetësisë konsideron se rreth 15% e popullsisë së botës kanë një lloj aftësie të kufizuara. Ndërsa, nga ky numër, rreth 2%, janë përdorues të karrocave. Në Kosovë nuk ka ndonjë statistike të saktë për numrin e tërësishëm të personave me aftësi të kufizuara. Besohet se situata në Kosovë është përafërsisht e njëjtë me këtë shifër. Të dhënat aktuale lidhur me aftësinë e kufizuara janë të shpërndara.

Në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, janë regjistruar gjithsejtë 93,288 persona me aftësi të kufizuara⁸.

2011 ⁹	Numri i regjistruar i PAK	%
PAK	93 288	Totali

⁶ European Union Kosova dhe HANDIKOS/Raport hulumtues/ STANDARDET NDËRKOMBËTARE MBI ÇËSHTJET E AFTËSISË SË KUFIZUAR KU QËNDRON KOSOVA? Vlerësim i legjislacionit të Kosovës në lidhje me çështjet e aftësisë së kufizuara në raport me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2020, f.7 http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/05/Report_SHQ-29_04_20_95548.pdf.

⁷ Qeveria e Kosovës, Vendimi Nr. 08/46 date 30.11.2022, <https://handi-kos.org/vendimi-i-qeverise/>.

⁸ World Bank Group, Social Development, Country Profile Kosova, Disability Inclusion, f.1, shifrat në këtë tabelë burojnë nga regjistrimi i popullsisë të vitit 2011. Nuk ka statistika të saktë për numrin e PAK.

⁹ World Bank Group, Social Development, Country Profile Kosova, Disability Inclusion, f.1, shifrat në këtë tabelë burojnë nga regjistrimi i popullsisë të vitit 2011. Nuk ka statistika të saktë për numrin e PAK.

F	49 910	53.6 %
M	43 379	46.4 %

Aktualisht, sipas të dhënave nga HANDIKOS, në tabelën e mëposhtme është përfshirë numri i personave me aftësi të kufizuar që përfitojnë nga skemat sociale / pensione.

	Shkalla e aftësisë së kufizuar	Shkalla (1-3-5 apo "pa-limit")	Numri i përfituesve aktual
Familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar 1-18 vjet	Aftësia e kufizuar e përhershme	I përhershëm deri në moshën 18 vjeç	2,600
Personat me Aftësi të Kufizuar	Aftësia e mbetur për punë	1,3 apo 5 vite	19,000
Të verbrit	Shkalla e verbërisë	3 apo 5 vite	1,800
Paraplegjik dhe Tetraplegjik	Aftësia për të lëvizur/funksionit	3 apo 5 vite	3,000
Gjithsejtë			26,400

METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij raporti është analiza e përputhshmërisë së kornizës legjislative të Kosovës me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Analiza ka synim që të përfshijë gjithashtu një pasqyrë të përputhshmërisë së legjislacionit me rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Ndërsa, qëllimi i Metodologjisë¹⁰ është të sigurojë një përmbajtje uniforme dhe qasje formale në shkrimin e Draft Analizës së Kornizës Legjislative për sektorët e mëposhtëm:

Qasshmërisë - Neni 9 i KDPAK

Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike – Neni 29 i KDPAK

Analiza e përputhshmërisë së kornizës legjislative të Kosovës me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, d uke përfshirë edhe një përmbledhje të pajtueshmërisë së legjislacionit me rekomandimet e Komitetit të KB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, bazuar në këtë metodologji ka për synim që rezultatet e analizës të jenë të krahasueshme sipas sektoreve për të gjitha vendet pjesëmarrëse si Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria; të krijohet një bazë e unifikuar për përcaktimin e rekomandimeve për përmirësimin e legjislacionit në sektorët e përcaktuar në nivel kombëtar; dhe të ndihmojë në zbatimin e aktiviteteve të projektit në nivelin rajonal.

Kjo metodologji ka përcaktuar se për këtë analizë të përdoren disa metoda për mbledhjen e informacionit. Metodatat e propozuara, përmbajnë, por nuk kufizohen në:

Pyetje të përgjithshme të cilat janë të domosdoshme për të bërë analizën/vlerësimin.

Krahasimi i kornizës ligjore me KDPAK nga grupet punuese legjislative të formuara në dy sektorët për analizë.

Draft analizën e kornizës ligjore në Kosovë në krahasim me nenet e KDPAK.

Forma e përmbledhur tabelore e Analizës së Kornizës Ligjore.

Metodologjia është përcaktuar për tre vende pjesëmarrëse në projektin "Aleancat e Aftësisë së Kufizuar për Zhvillimin e Reformave Gjithëpërfshirëse në Rajon" (DADIRR), dhe do të tërheqë vëmendje të veçantë në përputhjen e legjislacionit me rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara¹¹.

1. Metodatat për të përmbushur kërkesën për pyetjet e përgjithshme të domosdoshme për këtë analizë përfshijnë: hulumtimi i legjislacionit vendore, hulumtimi i Konventës dhe interpretimet e ndryshme të përmbajtjes së neneve të Konventës, raportet e Komiteteve përkatëse në kuadër të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, raportet dhe analizat e organizatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, intervistat dhe konsultimet formale dhe joformale me organizatat e personave me aftësi të kufizuara.

¹⁰ Metodologjia është përcaktuar kryesisht nga mbështetësi i projektit dhe nga hulumtimi i ekspertit të raportit.

¹¹ METHODOLOGY FOR DRAFTING THE ANALYSIS OF COMPLIANCE OF THE LEGISLATIVE FRAMEWORK WITH THE UN CONVENTION ON THE RIGHTS OF PERSONS WITH DISABILITIES

2. Metodatat për të përmbushur kërkesën për detyrat e gupeve punuese për hartimin e Draft Analizës së Kornizës Ligjore të Kosovës, përfshinë: formimin e dy grupe punuese legjislative, një për qasje dhe një për pjesëmarrje në jetën publike dhe politike, me nga 5 -6 anëtarë, përfaqësues të OPAK -ve dhe institucioneve¹². Në këtë komponentë janë mbajtur gjithsejtë pesë (5) takime, tre (3) me grupin punues legjislativë për qasje dhe dy (2) me grupin punues legjislativë për pjesëmarrje, në të cilat janë trajtuar legjislacioni i Kosovës për aftësinë e kufizuar dhe kërkesat e KDPAK. Në fund të takimeve, anëtarët e grupeve punuese, disa nga ata, kanë dërguar edhe nga një kopje prej formës së punuar nga eksperti lidhur me kërkesat për secilën fushë.

3. Draft analiza e legjislacionit është hartuar nga eksperti i raportit edhe në bazë të kontributit të grupeve punuese dhe takimit përmes platformës ZOOM, ku persona me aftësi të kufizuar dhe përfaqësues të shoqërisë civile kanë dhënë kontributin e tyre për plotësimin e draft kornizës ligjore dhe rekomandimeve për intervenim dhe autorit të analizës.

4. Forma e përmbledhur e raportit është bazuar në Draft Analizën e Kornizës Ligjore për legjislacionin në shënjestër për personat me aftësi të kufizuar, kontributet e pjesëmarrësve në grupe punuese legjislative dhe pjesëmarrësve në takimin me platformën ZOOM, me intervenimin substancial të ekspertit dhe PAK -ve, me fokus në qasje dhe pjesëmarrje.

Përfundimet dhe rekomandimet bazohen në të gjeturat dhe intervenimet e propozuara nga personat me aftësi të kufizuar.

¹² HANDIKOS, SHVK, SHKSH, KQZ, Avokati I Popullit.

I. AKTET JURIDIKE QË TRAJTOJNË ÇËSHTJET E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Dispozitat me të cilat janë rregulluar dhe trajtuar çështjet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë gjenden në aktet e juridike të përgjithshme dhe të veçanta të zbatueshme në Kosovë, përfshirë Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Aktet e përgjithshme në Kosovë gjenden në formën e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative, vendimeve qeveritare, të cilat janë të detyrueshme për zbatim, çoftë në nivel nacional dhe lokal. Ndërsa, çështjet që trajtojnë personat me aftësi të kufizuar gjithashtu janë të përfshira edhe në dokumentet e politikave, si në strategji dhe plane veprimi, dokumente këto që prezantojnë përpjekjet institucionale për ta adresuar misionin, vizionin, objektivat për trajtimin e një komponente të caktuar që në këtë rast janë çështjet e aftësisë së kufizuar. Dispozita ligjore për persona me aftësi të kufizuar mund të këtë edhe në akte tjera ligjore të cilat nuk janë listuar me poshtë. Por për qëllim të kësaj analize ne do ti referohemi këtyre akteve ligjore për të analizuar përputhshmërinë në sektorët e qasjes dhe pjesëm arrjes.

1) KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS¹³

Kushtetuta është akti më i lartë politik -juridik i Republikës së Kosovës. Si akti më i lartë në hierarkinë e akteve ligjore, dispozita e nenit 16 e kësaj Kushtetute ka përcaktuar se të gjitha ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në anën tjetër ka pranuar se *Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës*. Për më shumë paragrafi 2, i Nenit 19, përcakton se *Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës*. Kjo dispozite kushtetuese i ka vendosur instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare në hierarki me të lartë se sa ligjet e Kosovës.

Kushtetuta e Kosovës, mbron dhe garanton një spektër të gjerë të drejtave të njeriut të përfshira në kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore]¹⁴, duke përcaktuar në parimet e përgjithshme edhe se *Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës*. Ndër të tjera, kushtetuta ka garantuar barabarësinë e pakufizuar të gjithë njerëzve para ligjit pa diskriminim, Neni 24 [Barazia para Ligjit] duke përcaktuar si bazë edhe aftësinë e kufizuar, përfshirë masat alternative për grupet e pabarabarta.¹⁵

Kushtetuta, nuk e ka trajtuar në mënyrë eksplicite të drejtën për qasje dhe pjesëmarrje në jetën publike për persona me aftësi të kufizuar. Megjithatë, në këtë referencë, në kapitullin e II për të Drejtat e Njeriut, përfshirë edhe dispozitat lidhur me parime të mos diskriminimit

¹³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, është shpallur me 15 qershor 2008, dhe pesë (5) amendamente Kushtetuese, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

¹⁴ Kapitulli II, i Kushtetutës, është kapitulli me i vëllimshëm i Kushtetutës, me gjithsejtë 42 nene, "Ai i është dedikuar lirive, të drejtave dhe obligimeve të njeriut dhe të qytetarit, mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, barazisë para ligjit dhe zbatimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare". (Komentari, f.79).

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24.

janë ndërtuar parimet bazë lidhur me fushat më të rëndësishme duke garantuar barabarësinë e të gjithë personave. Ndërsa, sa i përket pjesëmarrjes në jetën politike, në mënyrë eksplicite janë garantuar të drejtat për të zgjedhë dhe për t'u zgjedhur dhe të pjesëmarrjes për secilin person, Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]. Në mënyrë eksplicite si e drejtë individuale është garantuar edhe liria e secilit person për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate, Neni 44 [Liria e Asociimit].

Meqenëse, Republika e Kosovës nuk është anëtare e OKB-së dhe si e tillë nuk mund të aderohet në instrumente ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Kushtetuta ka afirmuar zgjidhje kushtetuese, ashtu që një numër i instrumenteve ndërkombëtare janë përfshirë në nenin 22, të Kushtetutës, [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]¹⁶, të cilat instrumente zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës. Për më shumë, Kushtetuta u ka dhënë instrumenteve ndërkombëtare prioritet në rast konflikti ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjer a të institucioneve publike. Në këtë referencë është shumë e rëndësishme fakti se me datë 01 Gusht 2023, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka vendosur që Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara t ë jetë pjesë e nenit 22 të Kushtetutës. Amandamenti i Kushtetutës, pritet të behet ditëve në vazhdim, pasi që ky ndryshim të votohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ¹⁷.

Gjithashtu, Kushtetuta e ka ngritur standardin e interpretimit të drejtave të njeriut në nivelin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu që, Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], *Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendi met gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, duke ofruar mbrojtje ligjore, Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

¹⁶ Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. (9) Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje)* Me amendament kushtetues ka miratuar edhe përfshirjen e saj ne Kushtetute ne paragrafin 9/ GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 4 / 30 SHTATOR 2020, PRISHTINË/ AMENDAMENT I KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS Nr. 07-V-058 25 shtator 2020

¹⁷ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ka vendosur lidhur me kërkesën në rastin KO 207/22, parashtruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të amendamentit të propozuar kushtetues. Kërkesa është parashtruar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe është dorëzuar në Gjykatë, më 21 dhjetor 2022, bazuar në paragrafin 9 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, sipas të cilit, Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara për vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar kushtetues i pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës.

<https://qjk-ks.org/njoftim-per-vendim-ne-rastin-ko-207-22/>

Nga vështrimi me lartë konstatojmë se, Kushtetuta e Kosovës përfshinë një spektër të gjithmbarshëm të drejtave të njeriut. Duke përfshirë faktin se instrumenteve ndërkombëtare të numëruara në nenin 22, u ka dhënë epërsi ndaj ligjeve të Kosovës, dëshmon se fryma e kushtetutës është e orientuar ndaj respektimit të drejtave të njeriut dhe standardeve ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut.

2) LIGJI Nr. 04/L – 092 PËR PERSONAT E VERBËR¹⁸

Ligji për Personat e Verbër, ka rregulluar pozitën, të drejtat dhe detyrimet e personave të verbër si njeri nga komunitetet e personave me aftësi të kufizuar.

Neni 4 i këtij ligji ofron mbrojtje për personat e verbër në formën e mbrojtjes nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes talljes dhe gëzimin e të drejtave dhe lirive të tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në vështrimin mbi sektorin e qasjes, ligji i ka normuar fare pak ose pjesërisht fushën e qasjes. Gjithsesi në të janë përfshirë dispozita ligjore që adresojnë pjesërisht qasjen në informacion, Neni 11, [*Qasja në informacion*], udhëtimin për persona të verbër dhe shoqëruesit e tyre, Neni 13 [*Udhëtimin*] dhe ka përcaktuar detyrimin për institucionet përgjegjëse për sigurimin e përshtatjeve të nevojshme dhe të mundshme për personat e verbër, Neni 15 [*Përfitimet dhe të drejtat tjera*]. Për zbatimin e këtij ligji, janë miratuar edhe këto dy akte tjera juridike.

3) LIGJI Nr. 05/L –067 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E PERSONAVE PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK¹⁹

Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik ka rregulluar pozitën, të drejtat dhe detyrimet e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, si komunitet i personave me aftësi të kufizuar.

Në dispozitat fillestare është garantuar mbrojtja e dinjitetit dhe respekti për integritetin fizik dhe psikik të personave me aftësi të kufizuar (paraplegjik dhe tetraplegjik) në bazë të barabartë me personat e tjerë, Neni 5 [*Mbrojtja e integritetit të personit*] dhe mbrojtja nga të gjitha format e diskriminimit, Neni 4 [*Mbrojtja*], duke përcaktuar mbrojtjen të bazuar në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të njohura nga Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut e me theks të veçantë me standardet dhe parimet e përcaktuara me Konventën Ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Edhe pse në disa nga dispozitat i është referuar qasjes/tipit të qasjes, nuk ka ndonjë dispozite ekskluzive që e materializon në mënyrë të plotë qasjen apo qasshmërinë në

¹⁸ Ligji Nr. 04/L-092 për Persona të Verbër, hyrë në fuqi 18 Korrik 2012, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 20 / 18 KORRIK 2012, PRISHTINË, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2837>.

¹⁹ Ligji Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, hyrë në fuqi 16 Qershor 2016, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 19 / 16 QERSHOR 2016, PRISHTINË, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12554>

kuptimin e domosdoshmërisë së këtij komuniteti. Për zbatimin e këtij ligji, janë miratuar dy akte tjera juridike.

4) LIGJI Nr. 03/L-019 PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA²⁰

Ky ligj ka për qëllim që tu ofrohet përkrahje ligjore dhe institucionale personave me aftësi të kufizuara, për aftësimin, riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim të përshtatshëm, njësoj me të tjerët.

Nuk i trajton në mënyrë specifike sektorët tonë të përcaktuar në këtë analizë, por meqenëse dispozitat ligjore që adresojnë sektorët specifik të kësaj analize janë të shpërndara në disa akte ligjore, e kemi listuar edhe këtë ligj. Sepse është njëri nga ligjet e pakta, në mos i vetmi i cili e ka definuar *aftësinë e kufizuar, personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e personave me aftësi të kufizuara*. Dhe, meqenëse me këtë ligj rregullohen dhe përcaktohen të drejtat, kushtet, mënyrat e aftësim it, riaftësimit profesional dhe punësimit të personave me aftësi të kufizuara, ndërsa me qëllim të integritimit të tyre në tregun e hapur të punës e ka adresuar konceptin e përshtatshmërisë së mjedisit në reference të sektorit të qasshmërisë, Neni 3 [*Përshtatshmëria e mjedisit*] dhe [*Mjetet ndihmëse*], që ndër veprojnë me sektorin e qasjes. Gjithashtu, ligji përfshinë dispozita ligjore lidhur me diskriminimin.

Ky ligj është ndryshuar me LIGJI NR. 05/L -078 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-019 PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, përmes së cilit janë ndryshuar disa nga shprehjet e ligjit bazik, posaçërisht pjesa për përcaktimin e aftësisë së kufizuar, personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Në kuadër të këtij ligji janë miratuar edhe rreth tetë (8) rregullore dhe udhëzime administrative, të cilat gjenden të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës²¹.

5) LIGJI NR. 04/L-131 PËR SKEMAT PENSIONALE TË FINANCUARA NGA SHTETI²²

Përmes këtij ligji janë rregulluar skemat pensioneve të cilat financohen nga shteti në të cilën janë përfshirë edhe pensionet për persona me aftësi të kufizuara dhe është përcaktuar *E drejta në pension të aftësisë së kufizuar*, Neni 4.

[*Qëllimi*] Neni 1, i këtij ligji është, të përcaktojë llojet e pensioneve, ku përfshihen edhe pensionet e aftësisë së kufizuar si pensione të Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti. Ndërsa, në Nenin 3 [*Përkufizimet*], e definojnë atë si *Pensioni i pa aftësisë së përhershme - pensioni i rregullt mujor i paguar për qytetarët e Republikës së Kosovës, bazuar në vendimin*

²⁰ Ligji Nr. 03/L-19 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, hyrë në fuqi me 25 Janar 2009, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 47 / 25 JANAR 2009, <https://qzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2620>

²¹ <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2620>

²² Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, hyrë në fuqi me 05 Qershor 2014, plotësuar dhe ndryshuar në vitin 2023, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.35 / 05 QERSHOR 2014, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2486>

e organit përkatës të Ministrisë të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj. Kushtet dhe kriteret janë të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji. UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPMS) NR.06/2015 PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT PËR PENSIONIN E PAAFTËSISË SË PËRHERSHME, rregullon dhe përcakton procedurat administrative përmes së cilës personave me aftësi të kufizuar u realizohet e drejta për pension.

6) LIGJI NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS²³

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme është hartuar me qëllim të përcaktimit të rregullave të organizimit të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demo kratike për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ligji në dispozitën e nenit 4 për [Parimet Themelore], ka garantuar [Lirinë dhe fshehtësinë e votës], Neni 6 [E drejta për të votuar], Neni 89 [E Drejta e Votës dhe Fshehtësia e Votës], Neni 59, të sigurojë që vendvotimet të janë në vend të qashtëm , Neni 83 [Lokacionet e Vendvotimeve dhe Qendrat e Vendvotimeve].

Ligji për zgjedhje të përgjithshme në Kosovë i ka kushtuar hapësirë personave me aftësi të kufizuar ngase një numër dispozitave ligjore në mënyrë ekskluzive i dedikohen këtij komuniteti. Gjithashtu, një kapitull i veçantë në mënyrë shprehimore rregullon votimin e personave me aftësi të kufizuar, Neni 99 [Dispozitat e Përgjithshme]²⁴, duke përcaktuar se, KQZ-ja përcakton rregullat për votim për personat me nevoja të veçanta .

Ndërsa, qasja në informim dhe transmetimi i informatave për personat me aftësi të kufizuar është adresuar në dispozitat e Nenit 107, [Informimit të votuesve dhe mediave], dhe Neni 108 [Transmetimi i informatave për votuesit], përfshirë dhe materialin informues për njerëzit me dëgjim të dëmtuar në gjuhën adekuate për nevojat e grupeve gjuhësore të cilat shërbehen nga transmetuesi.

7) LIGJI NR. 03/L-072 PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS²⁵

Ligji për zgjedhjet lokale është hartuar me qëllim të administrimit të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike për Kuvendet e Komunave dhe Kryetarët e Komunave dhe me qëllim të fuqizimit të qeverisjes lokale demokratike.

Në parim, shumica e dispozitave ligjore të ligjit për zgjedhje të përgjithshme janë të aplikueshme dhe të ngjashme edhe në këtë ligj. Dispozitat e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës vlejné njësoj edhe për zgjedhjet lokale.

8) LIGJI NR. 06/L- 043 PËR LIRINË E ASOCIIMIT NË ORGANIZATA JOQEVERITARE²⁶

²³ Ligji NR. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 14 / 3 KORRIK 2023, PRISHTINË, me të cilin ligj janë shfuqizuar ligjet e mëparshme për zgjedhje të përgjithshme në Kosovë, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544> .

²⁴ Kreu XV/ Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta .

²⁵ Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, hyrë në fuqi me 15 Qershor 2008, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 32 / 15 QERSHOR 2008, <https://qzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2549>.

Liria e Asociimit është e drejtë e cila buron nga Kushtetuta e Kosovës. Me ligj të veçantë është rregulluar e drejta për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, përfshirë këtu edhe lirinë e shprehjes dhe mendimit, lirinë e tubimit, lirinë për të kërkuar, pranuar dhe përdorur burimet dhe disa parime tjera në funksion të asociimit. Ligji nuk e adreson ekskluzivisht lirinë e asociimit për persona me aftësi të kufizuara por krijon garanci për të drejtën e secilit person për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.

9) LIGJI Nr. 05/L -021 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI ²⁷

Edhe pse shumica e ligjeve të listuar më lartë kanë në dispozita të tyre përmbajtje lidhur dhe kundër diskriminimit, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi Nr. 05/L -021, e ka ezauruar në mënyrë jashtëzakonisht të mirë çështjet që bien në domenin e diskriminimit. Në mënyrë të veçantë dhe konform edhe me dispozitat kushtetuese, ky ligj e njeh aftësinë e kufizuar si bazë e diskriminimit Neni 1 [Qëllimi] *Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës , lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose mart esore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, kështu që ofron mbrojtje ligjore mbi secilën bazë të diskriminimit.*

Ky ligj ka definuar konceptin e diskriminimit dhe i njeh rreth dhjetë lloje të trajtimit të pabarabartë, Neni 4, shkelja e të cilave sipas bazave të përmendura në nenin 1, konsiderohet diskriminim.

Ligji ka trajtuar edhe shumë segmente të tjera përfshirë obligimet e institucioneve, mbrojtjen përmes procedurave gjyqësore në gjykatë dhe garancinë që ofrojnë realizimin e një spektri të gjerë të drejtave gjithnjë duke u thirrur në bazat e diskriminimit nga neni 1.

Në pajtim me nenin 11 (2) të Ligjit, [Mekanizmat institucional për mbrojtje nga diskriminimi në Ministri dhe Komuna], është hartuar rregullorja qeveritare:

10) RREGULLORE QRK - Nr. 03/2017 PËR MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI NË QEVERI DHE KOMUNA²⁸, qëllimi i së cilës është *përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësisive, të njësisive apo zyrtarëve përkatës për mbrojtje nga diskriminimi në ministri dhe komuna, si dhe mënyrës së koordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit të tyre me Zyrën për Qeverisje të Mirë si dhe me mekan izmat tjerë institucional për mbrojtje nga diskriminimi.*

²⁶ Ligji Nr. 06/L-43 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, hyrë në fuqi me 24 prill 2019, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 11 / 24 PRILL 2019, PRISHTINË, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=19055>

²⁷ Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, hyrë në fuqi me 26 qershor 2015, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 16 / 26 qershor 2015, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>.

²⁸ RREGULLORE QRK - Nr. 03/2017 PËR MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI NË QEVERI DHE KOMUNA, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>.

11) UDHËZIMI ADMINISTRATIV-Nr. 33/2007 PËR KUSHTET TEKNIKE TË OBJEKTEVE NDËRTIMORE PËR QASJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA²⁹

Udhëzimi administrativë referohet në bazën ligjore të Ligjit për Ndërtim. Me këtë *Udhëzim rregullohen kushtet teknike dhe mënyra e sigurimit të qasjes së papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuar dhe modernizimi i qasjes në objektet ndërtimore publike për destinim pune, banimi dhe banesor-afarist, si dhe kushtet dhe mënyra e përshtatshmërisë së thjeshtë të qasjes në objektin ndërtimor me destinim banimi dhe banesor-afarist.*

Në përkufizimet e këtij udhëzimi (neni 4), subjekt janë personi me aftësi të kufizuar dhe personi me lëvizje të vështirësuar, ndërsa Neni 5 i ka përcaktuar objektet të cilave u referohen obligimet nga ky akt: *objekteve ndërtimore publike dhe administrative; si dhe objekteve ndërtimore të banimit dhe banesore -afariste.*

12) RREGULLORE QRK Nr. 15/2014 PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS³⁰

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka aprovuar *Programin Kombëtar për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave për Personat e Shurdhër.*

Rregullorja është hartuar me qëllim që të përcaktojë rregullat dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës si dhe qasje në shërbimet e interpretimit, nëpërmjet Interpretëve të Gjuhës së Shenjave për Personat e Shurdhër. Fushëveprimi i saj shtrihet në të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe atë lokal duke përcaktuar se këto institucione janë të obliguara që personave nga komuniteti i të shurdhërve t'i ofrojnë shërbim sipas nevojës dhe kërkesave në gjuhën e shenjave (Neni2).

13) STRATEGJIA NACIONALE PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2013-2023³¹

Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013 -2023 *synonte të ofrojë një kornizë të qëndrueshme të veprimeve që kishte për qëllim të adresojë sfidat dhe pengesat si dhe të promovon një shoqëri gjithëpërfshirëse.*

Strategjia kishte për synim që të jetë një mekanizëm i rëndësishëm për të siguruar që parimet të cilat janë të mishëruara në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të janë inkorporuar në politikat dhe programet që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetesës së Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës.

Ishin përcaktuar pesë (5) objektiva strategjike:

1. *Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuar;*

²⁹ UDHËZIMI ADMINISTRATIV-Nr. 33/2007 PËR KUSHTET TEKNIKE TË OBJEKTEVE NDËRTIMORE PËR QASJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA. (Shfuqizuar me Vendim të QRK, Nr. 02/50 të datës 23.12.2021) - (Mbetet në fuqi me Vendimi të QRK, Nr. 05/56 të datës 26.01.2022) <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7480>.

³⁰ RREGULLORE QRK Nr. 15/2014 PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10363>.

³¹ http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/03/strategjia_nacionale_finale_per_shtyp_3_gjuhet_bardh_e_zi_88013-2.pdf.

2. *Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara;*
3. *Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara;*
4. *Qasje e barabarte në mbrojtje ligjore si dhe ofrimi i shërbimeve në nivelin lokal për përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;*
5. *Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe në krijimin apo vendosjen e një sistemi të unifikuar për të dhënat e Personave me Aftësi të Kufizuara.*

Me qëllim të zbatimit të objektivave strategjike në praktikë ishte paraparë dhe hartim i Planeve të Veprimit³² dhe përgjegjësinë për hartimin e Planeve të Veprimit i ishte atribuar të gjitha institucioneve në nivel qendror dhe lokal të cilat kishin marr pjesë në hartimin e Strategjisë në bashkëpunim me shoqërinë civile.

Meqenëse jemi në vitin e fundit të përfundimit të kësaj strategjie dhe një strategji e re dhjetë (10) vjeçare është duke u hartuar nga grupe punese, në këtë raport nuk do të ndalemi në analizimin e objektivave të kësaj strategjie.

³² Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021 -2023, <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41058>.

II. KONVENTA NDËRKOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR & REKOMANDIMET E KOMITETIT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR QASJE DHE PJESËMARRJE

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollin i saj janë adaptuar me 13 Dhjetor të vitit 2006 dhe kanë hyrë në fuqi me datë 03 Maj 2008, si përpjekje e gjithmbarshme e personave me aftësi të kufizuar për respektimin e të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Qëllimi i Konventës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 1, është *të promovojë, të mbrojë dhe të sigurojë gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe të promovojë respektin për dinjitetin e tyre.*

Konventa nuk ka dhënë një definicion të saktë për personat me aftësi të kufizuar për faktin se konsideron se nocioni "aftësive të kufizuara" është një koncept në zhvillim dhe assesi një koncept i ngurtë, sepse kryesisht varët nga mjedisi mbizotërues dhe ndryshon nga një shoqëri në tjetrën. Ndaj edhe si koncept evolues kryesisht do të duhej të determinohej në raport me barrierat mjedisore dhe të qëndrimeve sepse këto janë pengesat që zakonisht i hasin personat me aftësi të kufizuar për pjesëmarrje të plotë dhe efektive në shoqëri, në baza të barabarta me të tjerët³³.

Megjithatë, në nenin 1, Konventa ka përcaktuar se kush janë personat me aftësi të kufizuar duke determinuar se *Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat në ndërvëprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.*

Konventa e vë theksin kryesorë tek kategorizimi i bar rierave e jo i qenieve njerëzore, prandaj është me rëndësi që shkurtazi ti paraqesim qasjet e ndryshme ndaj aftësisë së kufizuar, e të cilat kategorizohen si:

Qasja e bamirësisë – që karakterizohet nga këndvështrimi se personat me aftësi të kufizuar konsiderohen se janë të paaftë që të kujdesen për veten për shkak të dëmtimit të tyre. Kjo qasje nuk merr parasysh fare asnjë kusht mjedisor. Ky këndvështrim sjellë në konkluzion se personat me aftësi të kufizuara janë objekt i keqardhjes dhe varen nga vullneti i mirë i shoqërisë.

Qasja mjekësorë – karakterizohet me fokusin tek dëmtimi i personit. Shkurt kjo qasje e mbështet këndvështrimin që personat me aftësi të kufizuara janë të sëmurë dhe duhet të trajtohen dhe njësoj si tek qasja e bamirësisë nuk e merr pa rasysh asnjë faktor mjedisor.

³³ UN/ UN Human Rights Office of the High Commissioner THE CONVENTION ON THE RIGHTS OF PERSONS WITH DISABILITIES/ Training Guide/ Professional Training Series/MODULE 2 – A SHORT INTRODUCTION TO THE CONVENTION, https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/CRPD_TrainingGuide_PTS19_EN_Accessible.pdf.

Qasja sociale është e ndryshme plotësisht nga dy qasjet e mëparshme dhe aftësinë e kufizuar e konsideron si pjesë të ndërveprimit të individit me një mjedis që nuk i përshtatet dallimeve të tyre. Kjo qasje konsideron se është e pikërisht mungesa e akomodimit të përshtatshëm ajo që e pengon pjesëmarrjen e individit në shoqëri dhe se pabarazia është jo për shkak të dëmtimit, por për shkak të paaftësisë të shoqërisë për të eliminuar barrierat sfiduese për personat me aftësi të kufizuara. Ky model është shumë më i avancuar në raport me dy të parët sepse e vendos personin në qendër, e jo dëmtimin e tyre.

Qasja e të drejtave të njeriut - buron nga qasja sociale dhe kjo e avancon edhe me tej këndvështrimin duke i njohur personat me aftësi të kufizuara si subjekte të të drejtave dhe shtetit, ndaj të tjerët kanë përgjegjësi për t'i respektuar këta persona. Kjo qasje i trajton barrierat në shoqëri si diskriminuese dhe ofron mundësi për personat me aftësi të kufizuara të ankohen kur përballen me pengesa të tilla. Në këtë kontekst Konventa e vë theksin kryesor tek qasja sociale dhe e të drejtave të njeriut, me qëllim që personat me aftësi të kufizuar të trajtohen njësoj si personat e tjerë në shoqëri dhe të gëzojnë të drejta të barabarta.

Konventa ka 50 nene dhe një protokoll. Nga *neni 1* deri tek *neni 4* është rregulluar qëllimi, definicionet, parimet e përgjithshme, detyrimet e përgjithshme. Nga *neni 5* deri tek *neni 30*, janë të përfshira të drejtat specifike për personat me aftësi të kufizuar dhe çështjet e ndërlidhura ndër sektoriale. *Neni 31 dhe 32* trajtojnë çështjen e statistikave dhe bashkëpunimit ndërkombëtarë, ndërsa *nenet e tjera* rregullojnë çështjet e implementimit dhe monitorimit, Komitetet, Konferencën e Shteteve palë dhe dispozitat përfundimtare.

Protokolli Opsional i Konventës, e njeh të drejtën e individët dhe grupet e individëve për të paraqitur para Komitetit pretendime për shkelje të ndonjë prej dispozitave të Konventës. Protokolli Opsional gjithashtu lejon Komitetin, me pëlqimin e vendeve, të ndërmarrë hetime në vendet ku ka pasur prova të besueshme të shkeljeve të rënda ose sistematike të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara³⁴.

Për qëllim të kësaj analize ne do të trajtojmë të drejtat e garantuara të Konventës, sipas nenit 9, për qasshmërinë dhe nenit 29, lidhur me pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike, të cilat do të krahasohen me legjislacionin kombëtarë në Kosovë.

Edhe pse KDPK aktualisht nuk është instrument i aplikueshëm në Kosovë por që së shpejti pritet të behet, meqenëse Kosova aspiro për integritime evropiane, dhe në këtë proces kërkohet që të adoptohet legjislacioni konform kërkesave të A quis Communautaire, është koha që ligjvënësit të marrin parasysh kërkesat edhe për adaptimin e kornizës ligjor e për personat me aftësi të kufizuara, sepse këto janë standardet që kërkohen për përputhshmëri në këtë fushë.

³⁴ UN/ UN Human Rights Office of the High Commissioner THE CONVENTION ON THE RIGHTS OF PERSONS WITH DISABILITIES/ Training Guide/ Professional Training Series/MODULE 2 – A SHORT INTRODUCTION TO THE CONVENTION, https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/CRPD_TrainingGuide_PTS19_EN_Accessible.pdf, f.30.

1. QASJA/QASSHMËRIA

Qasja apo qasshmëria, si i referohemi ne komponentëve t ë tërësishme për pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuar në të gjitha aspektet e jetës për të siguruar barabarësi, është kusht themelor ë i Konventës.

Neni 9 Qasja

1. Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si gjithë të tjerë të kenë qasje në ambientet fizike, ndaj transportit, informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në lehtësime apo shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat do të përfshijnë evidentimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave ndaj qasjes do të zbatohen ndër të tjera:

- (a) Në ndërtesa, rrugë, transport dhe vende të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore apo ambientet e punës;
- (b) Informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe ato të urgjencës.

2. Gjithashtu, shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura për:

- (a) Të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale në lidhje me qasjen ndaj objekteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun;
- (b) Të siguruar që subjektet private të cilat ofrojnë objekte dhe shërbime të cilat janë të hapura apo të siguruara për publikun të marrin parasysh të gjitha aspektet e qasjes për personat me aftësi të kufizuar;
- (c) Të ofruar trajnim për aktorët e interesit lidhur me problemet që kanë të bëjnë më qasjen për personat me aftësi të kufizuar;
- (d) Të siguruar që ndërtesat dhe objektet e tjera publike të përmbajnë shenja në gjuhën Brail dhe në forma lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme;
- (e) Të siguruar forma asistencë direkt dhe të ndërmjetme duke përfshirë udhëzues, udhërrëfyes, lexues dhe interpretët profesionistë të gjuhës së shenjave, për të mundësuar qasjen në ndërtesa dhe objekte të tjera publike;
- (f) Të inkurajuar forma të tjera të përshtatshme të asistencës dhe mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar për tu siguruar që ata të kenë qasje në informacion;
- (g) Të nxitur qasjen e personave me aftësi të kufizuara ndaj e informacioneve të reja dhe sistemeve të teknologjive e reja të komunikimit, duke përfshirë dhe internetin;
- (h) Të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e teknologjive dhe sistemeve të qasshme të informacionit dhe komunikimit në një fa zë të hershme në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të qasshme me një kosto minimale.

Neni 9, i Konventës e trajton qasjen me tërë kompleksitetin e vet për personat me aftësi të kufizuara. Paragrafi 1, i këtij neni deklaron se *Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha*

aspektet e jetës, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar ashtu si gjithë të tjerë të kenë qasje në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në lehtësime apo shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale.

Paragrafi 1 i nenit 9, përcaktohen saktësisht dy komponentë të rëndësishëm për personat me aftësi të kufizuar, *jetesa e pavarur* dhe *pjesëmarrja e plotës* në të gjitha aspektet e jetës. Për këtë qëllim dispozita u ka kërkuar shteteve palë që së pari të marrin masa *për evidentimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave ndaj qasjes* dhe ka kërkuar që këto veprime të zbatohen ndër të tjera *a) Në ndërtesa, rrugë, transport dhe vende të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore apo ambientet e punës; (b) Informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe ato të urgjencës.* Me çka nënkuptojmë se në pikën a) dhe b) të paragrafit 1, janë ndërtuar standardet minimale lidhur me qasjen.

I mandatuar nga Konventa, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar³⁵, në sesionin e 11-të, të datës 31 Mars -11 Prill 2014, ka konstatuar se *Qasja është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë të pavarur dhe marrin pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në shoqëri.* Pa qasje në mjedisin fizik, transport, informacion dhe komunikim, duke përfshirë informacionin dhe teknologjitë dhe sistemet e komunikimit, në objekte dhe shërbimeve të tjera të hapura ose të ofruara për publikun, personat me aftësi të kufizuara nuk do të kishin mundësi të barabarta për pjesëmarrjen në shoqëritë e tyre përkatëse.

Komiteti ka konstatuar se është e rëndësishme që qasja të trajtohet në të gjithë kompleksitetin e saj, duke përfshirë mjedisin fizik, transportin, informacionin dhe komunikimin, dhe shërbimet. Neni 9, paragrafi 1, kërkon që shtetet palë të identifikojnë dhe eliminojnë pengesat dhe barrierat për qasjen, siç është përcaktuara në pikën a) dhe b). Objektet e tjera të brendshme dhe të jashtme të përmendura më sipër, duhet të përfshijnë *agjencitë për zbatimin e ligjit, gjykatat, burgjet, institucionet sociale, zonat për ndërveprim social dhe rekreacion, aktivitete kulturore, fetare, politike dhe sportive, si dhe objekte tregtare.* Të tjera shërbimet duhet të përfshijnë *shërbimet postare, bankare, telekomunikacioni dhe informacioni*³⁶.

Gjithashtu, Komiteti ka konstatuar se këto masa nuk kufizohen veten tek institucionet publike në kuptimin e pronësisë së institucioneve publike, por ka deklaruar se *për sa kohë që mallrat, produktet dhe shërbimet janë të hapura ose të ofruara për publikun, ato duhet të jenë të qasshme për të gjithë, pavarësisht nëse janë në pronësi dhe/ose ofruar nga një autoritet publik ose një ndërmarrje private*³⁷.

³⁵ UN/CRDP/C/GC/2/ Committee on the Rights of Persons with Disabilities Eleventh session/ General comment No. 2 (2014)/ 22 May 2014, f.1, file:///C:/Users/FastTech/Downloads/CRPD_C_GC_2-EN.pdf

³⁶ Si në index 35, pika 17, f. 6.

³⁷ Si në index 35, pika 13, f. 4.

Në reference të kërkesave nga paragrafi 1 i këtij neni, paragrafi 2, kërkon nga shtetet palë të marrin edhe masa shtese **të duhura** ashtu siç janë përcaktuar në paragrafin 2 nga pika *a* deri tek pika *h*.

Ndaj, kërkesat e nenit 9 në par. 1 dhe 2 janë mjaft të zgjeruara në kuptim të obligimeve të shtetit dhe veprimeve të cilat do të duhet të ndërmerren shtetet për të siguruar zbatim të plotë të standardeve të kërkuara në këtë nen.

Obligimet e shteteve palë në kontekstin e Konventës janë por nuk kufizohen në: kryerjen e analizave të mirëfillta për ti identifikuar barrierat që ekzistojnë; të heqin barrierat në mënyrë graduale; të miratojnë, shpallin dhe monitorojnë standardet kombëtare të qasshmërisë; miratimi i një kuadri ligjor të përshtatshëm nëse nuk ekziston; ndërmarrja e një rishikim gjithëpërfshirës të ligjeve për qasjen në mënyrë që të identifikojnë, monitorojnë dhe adresojnë boshllëqet në legjislacion dhe zbatim; të përfshijnë TIK-un në përkufizimin e tyre të qasshmërisë; ligje për të drejtat e aftësisë së kufizuar që kanë të bëjnë me qasje jo diskriminuese në fusha të tilla si prokurimi, punësimi dhe arsimit dhe në mallra dhe shërbime qendrore për shoqërinë moderne që ofrohen nëpërmjet TIK-ut dhe formave tjera njësojë si për njerëzit tjerë³⁸

Gjithashtu, komiteti ka konstatuar se është e nevojshme të vendosen standarde minimale për qasjen në shërbime të ndryshme të ofruara nga ndërmarrjet publike dhe private.

Komiteti ka konstatuar se *Detyrimi i shteteve palë për të siguruar qasje në mjedisin fizik, transport, informacion dhe komunikim dhe shërbime të hapura për publikun për personat me aftësi të kufizuara duhet parë nga këndvështrimi i barazisë dhe mos diskriminimit. Mohimi i qasjes në mjedisin fizik, transportin, informacionin dhe komunikimin dhe shërbimet e hapura për publikun përbën një akt diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar që ndalohej nga neni 5 i Konventës.*³⁹ Sigurimi i qasshmërisë duhet parë në kontekstin e zbatimit të detyrimit të përgjithshëm që rrjedhin nga neni 4 i Konventës.

Kërkesat e Komitetit për standardet e qasshmërisë janë por nuk kufizohen për ligje të përgjithshme dhe specifike për aftësinë e kufizuar në fusha për mjedisin fizik, në ligjet për ndërtimin dhe planifikimin; në fushën e transportit, në ligjet për transportin publik ajror, hekurudhor, rrugor dhe ujor; në fushën e informacionit dhe komunikimit dhe në shërbime të hapura për publikun. Konventa, komiteti dhe standardet e qasshmërisë e përcaktojnë qartë se *Mohimi i qasjes duhet të përkufizohet qartë si një akt i ndaluar diskriminimi.*

Personat me aftësi të kufizuara të cilëve u është mohuar qasja në mjedisin fizik, transport, informacion dhe komunikim, apo në shërbimet e hapura për publikun duhet të kenë mjete ligjore efektive në dispozicion të tyre. Kur përcaktojnë standardet e qasshmërisë, shtetet palë duhet të marrin parasysh shumëllojshmërinë e personave me aftësi të kufizuara dhe të sigurojë që qasja u jepet personave të çdo gjinie dhe të gjitha moshave dhe llojeve të aftësisë së kufizuar. Pjesë e shumëllojshmërisë të personave me aftësi të kufizuara në ofrimin e qasjes, përfshinë edhe pranimin se disa persona me aftësi të kufizuara kanë nevojë për

³⁸ Si në index 35, pika 28, f. 8.

³⁹ Si në index 35, pika 34, f. 10.

ndihmë të njerëzve ose kafshëve për të gëzuar qasje të plotë (si ndihma personale, interpretimi i gjuhës së shenjave, prekja ose qentë udhërrëfyes). Duhet të për caktohet, për shembull, se ndalimi i qenve udhërrëfyes nga hyrja në një ndërtesë të caktuar ose hapësirë të hapur do të përbënte një akt të ndaluar diskriminimi me bazë në aftësinë e kufizuar⁴⁰.

Shikuar nga kërkesat e nenit 9 dhe interpretimet e Komitetit, koncepti i qasshmërisë është mjaftë i gjerë dhe përfshinë të gjitha aspektet e jetës; kërkon intervenim të sinkronizuar në legjislacion dhe akte tjera që rregullojnë jetën e të gjithë personave brenda një shteti përfshirë këtu edhe të vetë personat me aftësi të kufizuar.

2.PJESËMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE

Neni 29 i Konventës, garanton pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën publike dhe politike ndaj dhe shtetet palë janë të obliguara që të garantojnë mundësinë që personat me aftësi të kufizuar ti gëzojnë të drejtat nga ky nen njësoj si pjesa tjetër e popullatës.

Neni 29 Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

Shtetet Palë duhet t'ju garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullsisë dhe duhet të marrin përsipër:

(a) Tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësitë kufizuar për të votuar dhe për tu zgjedhur, ndër të tjera duke:

- (i) Siguruar që procedurat, objektet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të qasshme dhe të thjeshtë për tu kuptuar dhe përdorur;
- (ii) Mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të votuar me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, për të kandiduar në zgjedhje, për të ushtruar funksione publike dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive asistuese dhe të reja, në rastet e përshtatshme;
- (iii) Garantuar shprehjen e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistencë në votim nga një person i zgjedhur prej tyre.

(b) garantimin e një ambienti, në të cilin personat me aftësi të kufizuar mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në dirigjimi në çështjeve publike, pa diskriminim dhe njësoj si të tjerët dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike, duke përfshirë:

- (i) Pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend dhe në akt ivitetet dhe administrimin e partive politike;
- (ii) Krijimin apo pjesëmarrjen në organizata të personave me aftësi të kufizuar për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale

⁴⁰ Si në index 35, pika 29, f. 9.

Çështjet kyçe në kërkesat e nenit 29 janë: pjesëmarrja e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërdrejt apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, të drejtën dhe jo vetëm të drejtën por edhe mundësinë për të votuar dhe për tu zgjedhur. Pika a), më shumë i referohet të drejtës për pjesëmarrje për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur dhe kryesisht shikohet në kontekstin e të drejtës së votës. Kështu që kërkon ndër marrjen e një varg veprimesh legjislative dhe operative për tu siguruar se janë garantuar dhe zbatuar të drejtat që dalin nga neni 29.

Pika (b), në anën tjetër është edhe më e gjerë në kuptimin formal të shtrirjes institucionale, sepse ka të bëjë më shumë me pjesëmarrjen efektive në dirigjimin e çështjeve publike që përfshihen, së paku: pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike dhe krijimin apo pjesëmarrjen në organizata të personave me aftësi të kufizuar për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.

Komiteti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në komentet e përgjithshme me Nr. 7, të vitit 2018, deri sa ka komentuar dhe rekomanduar lidhur me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuar, përmes organizatave të tyre përfaqësuese në zbatimin dhe monitorimin e Konventës, ka trajtuar edhe pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike të personave me aftësi të kufizuar.

*Personat me aftësi të kufizuara ende përballen me barriera të rëndësishme qëndrimi, fizike, ligjore, ekonomike, sociale dhe komunikuese për të marrë pjesë në jetën publike*⁴¹.

*E drejta e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike (neni 29) është e një rëndësie ekstreme në garantimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë dhe përfshirë plotësisht dhe me efektivitet në shoqëri. E drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur është një komponent thelbësor i së drejtës për të marrë pjesë pasi që përfaqësuesit e zgjedhur vendosin për agjendën politike dhe janë kyç për të siguruar zbatimin dhe monitorimin e Konventës duke mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre*⁴².

Kërkohej nga Shtetet palë të miratojnë rregullore në konsultim të ngushtë me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, për të lejuar personat me aftësi të kufizuar që kërkojnë ndihmë të jenë në gjendje të japin votën e tyre vetë. Kjo mund të kërkojë vënien e mjeteve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara në kabinat e votimit (në ditën e zgjedhjeve dhe në votim paraprak) në zgjedhjet kombëtare dhe lokale dhe në referendumet kombëtare⁴³.

⁴¹ UN/CRPD/C/GC/7/Distr.: General 9 November 2018/Committee on the Rights of Persons with Disabilities/General comment No. 7 (2018) on the participation of persons with disabilities, including children with disabilities, through their representative organizations, in the implementation and monitoring of the Convention, 5, f. 2, file:///C:/Users/FastTech/Downloads/CRPD_C_GC_7-EN.pdf

⁴² Si në index 41, pika 88, f.16.

⁴³ Si në index 41, pika 89, f.16 dhe 17.

Pjesëmarrja e plotë dhe efektive nënkupton përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në organe të ndryshme vendimmarrëse, si në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe në institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, komitetet ad-hoc, këshillat rajonale ose organizatat komunale. Shtetet palë duhet të njohin në legjislacionin dhe praktikën e tyre që të gjithë personat me aftësi të kufizuara mund të emërohen ose zgjidhen në çdo organ përfaqësues: për shembull, sigurimi i emërimit të personave me aftësi të kufizuara në këshillat e aftësisë së kufizuar në nivel komunal, ose si bartës specifikë për të drejtat e aftësisë së kufizuar në përbërje të institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut⁴⁴.

Paragrafi b, i nenit 29 përfshinë garantimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në organizata joqeveritare dhe shoqata që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike, gjithashtu edhe në krijimin apo pjesëmarrjen në organizata të personave me aftësi të kufizuar për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.

Komiteti ka konstatuar se përfshirja dhe pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet "organizatave përfaqësuese", ose organizatave të personave me aftësi të kufizuara është e natyrshme. Për zbatimin e duhur të kërkesave të nenit, është e rëndësishme për shtetet palë dhe palët përkatëse të interesit të përcaktojnë fushëveprimin e organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe të njohin llojet e ndryshme që shpesh ekzistojnë.

Komiteti konsideron se organizatat e personave me aftësi të kufizuara duhet të jenë të rrënjosura, të përkushtuara dhe të respektojnë plotësisht parimet dhe të drejtat e njohura në Konventë. Ato mund të jenë vetëm ato që udhëhiqen, drejtohen dhe qeverisen nga persona me aftësi të kufizuara. Një shumicë e qartë e anëtarëve të tyre duhet të rekrutohen nga vetë personat me aftësi të kufizuara⁴⁵.

Komiteti sqaron se Organizatat "e" personave me aftësi të kufizuara duhet të dallohen nga organizatat "për" personat me aftësi të kufizuara të cilat ofrojnë shërbime dhe/ose avokojnë në emër të personave me aftësi të kufizuara. Shtetet palë duhet t'i kushtojnë rëndësi të veçantë pikëpamjeve të personave me aftësi të kufizuara, përmes organizatave të tyre përfaqësuese, të mbështesin kapacitetin dhe fuqizimin e organizatave të tilla dhe të sigurojnë që prioritet i jepet konstatimit të pikëpamjeve të tyre në proceset vendimmarrës⁴⁶. Komiteti, kërkon që çështjet për persona me aftësi të kufizuar të adresohen kryesisht nga pikëpamja e personave me aftësi të kufizuar në raport me pikëpamjet e organizatave përfaqësuese të tyre.

Në referencë të pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, Komiteti rekomandon se Shtetet palë duhet të forcojnë pjesëmarrjen e organizatave të personave me aftësitë e kufizuara në nivel ndërkombëtar,

⁴⁴ Si në index 41, f.7.

⁴⁵ Si në index 41, pika 10&11, f. 2.

⁴⁶ Si në index 41, f.4.

për shembull në forumin politik të nivelit të lartë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mekanizmat rajonalë dhe universalë për të drejtat e njeriut. Te pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara, nëpërmjet orga nizatave të tyre përfaqësuese, duke rezultuar kështu në efektivitet më të madh dhe përdorim të barabartë të burimeve publike, duke çuar në përmirësimin e rezultateve për këta persona dhe komunitetet e tyre⁴⁷.

Konventa kërkon edhe përfshirjen e shoqërisë civile në mekanizma nacional të zbatimit dhe monitorimit në nenin 33 [Zbatimi dhe monitorimi i Konventës në nivel kombëtar] ku kërkohet edhe pjesëmarrja e organizatave të personave me aftësi të kufizuara në këto mekanizma, meqenëse duke u përfaqësuar nga vetë personat, ngritët kualiteti i monitorimit dhe zbatimit.

Pa dyshim se edhe Konventa edhe Komiteti, në mënyrë ekskluzive adresojnë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në të gjithë fushat e mbuluara nga konventa, por në veçanti, adresojnë edhe pjesëmarrjen. *Për të gjithë aspektet që u thanë më lartë dhe Komiteti, Konventa, kërkojnë garantimin dhe angazhimin e organizatave e personave me aftësi të kufizuara që përfaqësojnë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara për të siguruar pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të tyre në të gjitha proceset e vendimmarrjes publike në një mjedis të sigurt, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e politikave në lidhje me të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, dhuna me bazë ndaj grave, përfshirë dhunën seksuale dhe abuzimin⁴⁸.*

⁴⁷ Si në index 41, f.7.

⁴⁸ Si në index 41, f.18.

III. STRATEGJIA E BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2021-2030⁴⁹

Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021 -2030 -Unioni për Barazi, ka për qëllim shtyrjen e mëtejme të progresit në sigurimin e pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara. Strategjia do të drejtojë veprimet e Shteteve Anëtare si dhe të institucioneve të BE-së, duke u mbështetur në arritjet e dhjetë viteve të mëparshmeve dhe duke ofruar zgjidhje për sfidat e ardhshme.

Strategjia ka për synim të përparojë në të gjitha fushat, Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si në nivel të BE -së ashtu edhe në nivel të shteteve anëtare.

Qëllimi është të sigurohet që personat me aftësi të kufizuara në Evropë, pavarësisht gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, moshës ose orientimit seksual: *gëzojnë të drejtat e tyre njerëzore; kanë mundësi të barabarta; të kenë qasje të barabartë për të marrë pjesë në shoqëri dhe ekonomi; janë në gjendje të vendosin se ku, si dhe me kë jetojnë; mund të lëvizin lirshëm në BE pavarësisht nga nevojat e tyre për mbështetje; nuk përjetojnë më diskriminim*⁵⁰.

Dokumenti i strategjisë ka në përmbajtjen e saj adresimin në fushat si, qasja, gëzimi i të drejtave të BE-së, cilësinë e mirë të jetës dhe jetesën e pavarur, qasje të barabartë dhe mos diskriminim, promovimin në nivel global të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, efikasiteti në ofrimin e strategjisë, udhëheqjen përmes shembullit, vetëdijesimin, qeverisjen dhe matjen e progresit.

Qasja është adresuar që në fillim të këtij dokumenti, sepse është konsideruar si mundësues i të drejtave, autonomisë dhe barazisë⁵¹. Qasshmëria konsiderohet si parakusht për pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët, me theks të veçantë në mjediset e ndërtuara dhe virtuale, për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK), mallrat dhe shërbimet, duke përfshirë transportin dhe infrastrukturën.

Komisioni, ka përmbledhur një varg kërkesash në kuadër të BE -së, sa i përket kuadrit legjislativë ashtu edhe për standardizimin e specifikave teknike në të gjithë fushat që përfshijnë qasjen dhe ka prezantuar një plan për ndërmarrjen e veprimeve. Në shtator të vitit 2022 ishte një qendër burimore evropiane *Accessible EU*, për të rritur koherencën në politikën e qasshmërisë dhe lehtësimin e qasjes në njohuritë përkatëse. Kjo kishte për qëllim që në kuadër të bashkëpunimit, ti bashkojë autoritetet kombëtare përgjegjëse për zbatimin e rregullave të qasjes me ekspertë dhe profesionistë nga të gjithë fushat e qasjes, për të ndarë praktikën e mira nëpër sektorë, për të frymëzuar zhvillimin e politikave në nivel

⁴⁹ Union of Equality- Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030
[file:///C:/Users/FastTech/Downloads/KE0221257ENN_002%20proof%20%20\(5\).pdf](file:///C:/Users/FastTech/Downloads/KE0221257ENN_002%20proof%20%20(5).pdf) .

⁵⁰ <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=738&langId=en&pubId=8376&furtherPubs=yes> .

⁵¹ Union of Equality- Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030, *Accessibility – an enabler of rights, autonomy and equality*, f.6.

kombëtar dhe të BE-së, si dhe për të zhvilluar mjete dhe standarde që synojnë të lehtësojnë zbatimin e ligjit të BE-së⁵².

Ngjarja për prezantimin e platformës *Accessible EU Launching Event (AW-EU-01)*⁵³, është mbajtur me 4 Korrik 2023. Ndërsa, fillimisht kjo platformë do të ofrojë: *biblioteka online për qasjen, rrjetëzim, trajnim për qasjen, monitorim dhe mbikëqyrje të qasjes dhe praktika tjera*.

Dokumenti i strategjisë, gjithashtu iu ka referuar pjesëmarrjes në pjesën e gëzimit të drejtave të BE-së, në pjesën për nxitjen e pjesëmarrjes në procese demokratike, duke nënvizuar se *Pjesëmarrja e plotë politike, siç kërkohet nga KDPAK, do të thotë që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në zgjedhje si dhe në proceset politike dhe vendimmarrëse në baza të barabarta me të tjerët*⁵⁴.

Komisioni, ka konstatuar se ka ende nevojë për progres, pavarësi sht disa hapave të marrë. Sepse zakonisht në praktikë ka vështirësi për personat me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtave të tyre qoftë për shkak të qasjes së kufizuar në informacion, komunikim, gjuhën e shenjave, qoftë të kufizimeve në kapacitetin e tyre ligjor. Prandaj strategjia synon të shtyje përpara pjesëmarrjen e plotë elektorale dhe qasjen në zgjedhjet evropiane (si votues dhe si kandidat), të qytetarëve të nën përfaqësuar duke përfshirë qytetarët me aftësi të kufizuara; avancimin e praktikave dhe demokracisë gjithëpërfshirëse me synimin që listat e kandidatëve të pasqyrojnë shumëllojshmërinë e shoqërive; *një udhëzues i Evropian për praktika të mirë zgjedhore që adreson pjesëmarrjen e qytetarëve me aftësi të kufizuara në procese zgjedhore; adresimi i nevojave të qytetarëve me aftësi të kufizuara në përmbledhjen e votimit; mbështetjen e pjesëmarrjes demokratike gjithëpërfshirëse, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, përmes programit të ri Shtetësia, Barazitë, të Drejtat dhe Vlerat*.

Megjithëse kjo strategji nuk është pjesë e analizës sonë, është e rëndësishme të merret parasysh në hartimin e planeve dhe politikave qeverit are për adresimin e çështjeve të personave me aftësi të kufizuara pasi që paralelisht me detyrimet për zbatimin e KDPAK-ut, Kosova duhet të shtyjë përpara procesin e aderimit në Bashkimin Evropian.

⁵² Union of Equality- Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030, f.8.

⁵³ <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?langId=en&catId=1612&eventsId=2111&furtherEvents=yes>.

⁵⁴ Union of Equality- Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030, f. 9.

IV OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM DHE AFTËSIA E KUFIZUAR

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), të njohura gjithashtu si *Objektivat Globale*, janë miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2015 si një thirrje universale për veprim për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur planetin dhe për të siguruar që der i në vitin 2030 të gjithë njerëzit të gëzojnë paqe dhe prosperitet.

Njësoj mbetet për të analizuar edhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm⁵⁵, që përfshinë 17 objektiva në Agjendën e vitit 2023 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Edhe pse në parim të gjitha objektivat kanë në shënjestër fusha që janë të rëndësishme për të gjithë njësoj, është numëruar se Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm e ka përmendur 11 herë aftësinë e kufizuar, posaçërisht e ka përfshirë atë në pesë (5) Objektiva, dhe atë në :

Objektivi 4 -Garantimi i arsimit të barabartë dhe të qasshëm, duke ndërtuar mjedise mësimore gjithëpërfshirëse dhe duke ofruar ndihmën e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara;

Objektivi 8- Promovimi i rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse, punësimi i plotë dhe produktiv që u mundëson personave me aftësi të kufizuara të qasen plotësisht në tregun e punës;

Objektivi 10- Përfshirjen sociale, ekonomike dhe politike të personave me aftësi të kufizuara;

Objektivi 11- Krijimi i qyteteve dhe burimeve ujore të qasshme, sistemeve të transportit të përballueshëm, të arritshëm dhe të qëndrueshëm, duke siguruar qasje universale në hapësira publike të sigurta, gjithëpërfshirëse, të qasshme dhe të gjelbra;

Objektivi 17 - Duke nënvizuar rëndësinë e mbledhjes së të dhënave dhe monitorimit të SDG-ve, theksi mbi të dhënat e ndara të aftësisë së kufizuar⁵⁶

⁵⁵ Sustainable Development Goals (SDG), <https://social.desa.un.org/issues/disability/sustainable-development-goals-sdgs-and-disability>.

⁵⁶ https://www.un.org/disabilities/documents/sdgs/disability_inclusive_sdgs.pdf.

V. KORNIZA LEGJISLATIVE E KOSOVËS PËR QASJEN DHE PJESËMARRJEN NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE

Korniza ligjore e Kosovës përbehet prej akteve juridike të cilat janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në sistemin juridik në Kosovë. Akti më i lartë politiko-juridik është Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Ligjet, rregulloret, udhëzimet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në përputhshmëri me dispozitat kushtetuese.

Ndryshe nga kapitulli I, ku kemi adresuar aktet juridike që trajtojnë aftësinë e kufizuar në përgjithësi, në këtë pjesë do të analizojmë aktet të cilat i kanë adresuar fuqishat me rëndësi për këtë analizë dhe atë të qasjes dhe pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike. Eventualisht, dispozita ligjore që trajtojnë aftësinë e kufizuar në përgjithësi dhe fushat specifike në veçanti mund të gjenden edhe në legjislacionin tjetër, por kujtojmë se legjislacioni i zgjedhur për këtë analizë meqenëse është ekskluziv për aftësinë e kufizuar, e ka të materializuar përmbajtjen vetëm për këtë fushë. Gjithashtu, edhe legjislacioni tjetër në Kosovë edhe nëse nuk ka adresuar çështjet e aftësisë së kufizuar në mënyrë specifike, ka adresuar çështje që rregullojnë fusha të caktuara të cilat e afektojnë jetën e secilit person dhe ato dispozita duhet të shihen në frymën e gjithëpërfshirëse.

Definicioni i Aftësisë së Kufizuar

Aftësia e kufizuar në legjislacionin e Kosovës, është definuar në dispozitat ligjore që rregullojnë aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar⁵⁷. Ligji i ka adresuar disa komponentë: *Aftësia e kufizuar; Personat me aftësi të kufizuara; Kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, si pasojë e dëmtimit*, etj.

Aftësia e kufizuar – është definuar si kufizim në qasje dhe aktivitete të zakonshme në jetën e përditshme të një personi *si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, intelektuale ose mendore, që e pengojnë atë për pjesëmarrje në aktivitetet e zakonshme ditore*.

Personat me aftësi të kufizuara – janë personat që kanë dëmtime fizike, shqisore, intelektuale ose mendore afatgjata të cilat në ndërvëprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.

Ndërsa gjithashtu janë definuar edhe ***Kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, si pasojë e dëmtimit*** në të cilat kategori hyjnë: invalidët e luftës, invalidët civil të luftës, invalidët e punës, personi i lindur me dëmtime fizike, shqisore, intelektuale ose mendore, dhe personi i cili si pasojë e fatkeqësisë apo sëmundjes ka aftësi të kufizuar fizike, shqisore, intelektuale ose mendore.

Në anën tjetër KDKPAK, nuk e ka një definicion të përcaktuar për aftësinë e kufizuar por duke e definuar si një koncept evolues, reflekton një model social të aftësisë së kufizuar ku sqaron

⁵⁷ LIGJI NR. 05/L -078 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-019 PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, Neni 3.

se paaftësia rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierat e jashtme që pengojnë pjesëmarrjen e tyre në shoqëri⁵⁸

Nëse i bëjmë një vështrim krahasues në mes të definicionit të aftësisë së kufizuar në Kosovë, përfundojmë se përderisa KDPAK reflekton një model social sepse e vë fokusin tek barrierat e jo tek dëmtimi/aftësia e kufizuar, definicioni i përcaktuar nga dispozita ligjore tek ne ndjek një model mjekësorë seps e e vë fokusin tek dëmtimet fizike, citoj '... si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, intelektuale ose mendore , që e pengojnë atë për pjesëmarrje në aktivitet e zakonshme ditore.

Ndaj, në kuadër të hartimit dhe ndryshim/plotësimit të legjisllacionit të Kosovës për të harmonizuar me KDPAK, një vëmendje e shtuar duhet ti kushtohet edhe mënyrës se si portretizohet aftësia e kufizuar në legjisllacion me qëllim që definicioni të reflektojë në frymën e kërkesave të KDPAK.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës për Qasjen dhe Pjesëmarrjen

Kushtetuta si akti më i lartë politik dhe juridik i shtetit i ka rregulluar dhe normëzuar institutet kryesore. Në Kushtetutë, nuk ka dispozita ekskluzive për qasjen për personat me aftësi të kufizuar. Në kapitullin e II, për të drejtat dhe liritë themelore, kushtetuta ka përcaktuar qartë detyrimin e shtetit për mbrojtje dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, duke garantuar se *1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara në këtë Kushtetutë. 3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. Neni 21 [Parimet e Përgjithshme].*

*Neni 24 [Barazia para Ligjit], kushtetuta ka garantuar barabarësinë e të gjithë personave para ligjit dhe mbrojtje ligjore, pa diskriminim. Ndërsa, paragrafi 2, i të njëjtit nen, ka numëruar edhe bazat e diskriminimit në të cilat baza përfshihet edhe *aftësia e kufizuar*. Garancia nga paragrafi 3, është i rëndësishëm sepse ka legjitimuar përdorimin e masave mbrojtëse me qëllim të avancimit të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë më të disfavourshme, duke mos i kufizuar në kohë por duke lejuar aplikimin e këtyre masave deri sa të arrihet qëllimi për të cilën janë vënë, *Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato, Neni 24, par.3.**

Kushtetuta e Kosovës, ka zgjeruar kuadrin ligjor të Kosovës në nivelin e shtetarëve ndërkombëtare, duke e përfshirë në Kushtetutë zbatimin e drejtpërdrejtë të instrumenteve ndërkombëtare e të cilave u ka njohur fuqinë e epërsisë ndaj dispozitave ligjore në rast të konfliktit, të cilat i ka listuar në nenin 22 të Kushtetutës.

⁵⁸ UN/ UN Human Rights Office of the High Commissioner THE CONVENTION ON THE RIGHTS OF PERSONS WITH DISABILITIES/ Training Guide/ Professional Training Series/MODULE 2 – A SHORT INTRODUCTION TO THE CONVENTION, https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/CRPD_TrainingGuide_PTS19_EN_Accessible.pdf, f.25.

Nëse e shikojmë këtë nen, evidentojmë që KDPAK, aktualisht nuk është e listuar në nenin 22⁵⁹. Mirëpo, ajo që gjejmë në këtë nen janë: *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj*; *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj*; *Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor*; instrumente këto të cilat kanë krijuar standarde, përfshirë diskriminimin dhe aftësinë e kufizuar.

Nëse këtë e referojmë tutje dhe e interpretojmë në lidhje me nenin 53, arrijmë në përfundim se Kushtetuat e Kosovës nuk është mjaftuar vetëm me krijimin e standardeve ndërkombëtare për garantimin e të drejtave por i ka fuqizuar tutje këto standarde të garantuara për të cilat kërkon të *interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Neni 53 [*Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut*] duke garantuar mbrojtje gjyqësore *në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur*, Nenin 54.

Ndërsa, në raport me fushën e pjesëmarrjes, Kushtetuta e Kosovës, në mënyrë eksplicite i ka normuar [*Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes*] Neni 45 dhe në Neni 44 [*Liria e Asociimit*]. Të dy këto të drejta janë rregulluar edhe me ligje të veçanta të cilat do ti trajtojmë me poshtë.

Kushtetuta në Neni 45 [*Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes*], i ka garantuar çdo shtetasi të Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim vetëm kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor, duke urdhëruar institucionet shtetërore për mbështetje të mundësive në pjesëmarrjen e secilit në *aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike*

Gjithashtu kushtetuta e ka garantuar [*Liria e Asociimit*] Neni 44. Përmes garantimit të kësaj të drejte u mundësohet *secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate*. Përfshirë që në këtë të drejtë në parim përveç kategorive të veçanta të punonjësve është garantuar edhe *Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar me qëllim që të mbrohen interesat*.

Mund të përfundojmë se, sa i përket sektorëve përkatës, Kushtetuta e Kosovës si akt më i lartë që është, ka ndërtuar parimet bazë lidhur me fushat më të rëndësishme duke garantuar barabarësinë e të gjithë personave në bazën e të cilave mund të adresohen edhe të drejtat nga të dy sektorët përkatës.

Ndaj, në kuadër të ndërhyrjeve, amandamentimi i nenit 22, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ashtu siç edhe është miratuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me të cilin do të përfshihet KDPAK në Kushtetutë, krijon një garanci të mjaftueshme ligjore për komunitetin e aftësisë së kufizuar në Kosovë dhe një bazament të fortë për adresimin e kuadrit ligjor të Kosovës në këtë fushë.

⁵⁹ Aktualisht, Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka miratuar përfshirjen e KNDPAK në nenin 22, Kushtetutës së Kosovës, tani pritet që Kuvendi i Kosovës ta votojë ndryshimin.

V.1 QASSHMËRIA

Në aspektin e të drejtave të njeriut, qasshmëria ka të bëjë me praktikën gjithëpërfshirëse të heqjes së barrierave për të siguruar qasje të barabartë për personat me aftësi të kufizuara, ndër të tjera, në mjedise të ndërtuara, mallra dhe shërbime, si dhe objekte ⁶⁰.

Sipas Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Neni 9, përcakton se, "për t'ju mundësuar personave me aftësi të kufizuara të jetojnë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për t'ju siguruar personave me aftësi të kufizuara qasje, në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Fjalët kyçe

Jetesa e pavarur; pjesëmarrja e plotë në të gjitha aspektet e jetës; qasje e barabartë në mjedisin fizik; qasje e barabartë në transport; qasje e barabartë në informacion dhe komunikim, duke përfshirë teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit; qasje e barabartë në objektet dhe shërbimet e tjera të hapura ose të ofruara për publikun, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale.

⁶⁰ Andrea Broderick, *of rights and obligations: the birth of accessibility*, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/13642987.2019.1634556#:~:text=Accessibility%20refers%20to%20the%20inclusive,services%2C%20as%20well%20as%20facilities.>

Në referencë të qasjes si një nga parakushtet kryesore për personat me aftësi të kufizuar që mundëson realizmin e të drejtave të tjera, Kosova nuk qëndron fare mirë në raport me mundësimin dhe ofrimin e qasjes në mjedise fizike, transport, informim dhe komunikim dhe shërbime publike. Në raportin e Hulumtimit, "Ku qëndron Kosova", rezulton se sa i përket qasjes vetëm 6.77 %, të normatives ligjore plotësojnë kushtet e standardit të plotësuar në krahasim me KDPAK⁶¹. Zakonisht këto analiza janë bërë kryesisht në zonat urbane. Zonat rurale nuk janë adresuar në asnjë rast. Në shumë qytete, në zonat urbane viteve të fundit ka pasur intervenime të infrastrukturës rrugore dhe të mjediseve publike. Gati në asnjë qytet nuk janë adresuar në tërësi elementet për qasje të personave me aftësi të kufizuar. Edhe në rastet kur janë adresuar, shumica e atyre elementeve nuk i plotësojnë kushtet e specifikave teknike, p.sh janë ndërtuar pjerrina të cilat e kanë këndin e ngritjes shumë të lartë me çka pamundësojnë kalimin në mënyrë të pavarur të përdoruesit të karrocës në atë pjerrinë ose janë pa sipërfaqe taktore.

Raportet e ndryshme për qasje, përfundojnë që pa varësisht përpjekjeve ky standard është shumë ulët për tu vlerësuar.

Qasja, si një nga parakushtet themelore për realizmin e të drejtave tjera për personat me aftësi të kufizuar, në mënyrë specifike është adresuar vetëm në UDHËZIMI ADMINISTRATIV – Nr. 33/2007 PËR KUSHTET TEKNIKE TË OBJEKTEVE NDËRTIMORE PËR QASJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA. Ndërsa, dispozita që i referohen disa aspekteve të qasjes, janë përfshirë edhe në disa ligje të veçanta që adresojnë personat me aftësi të kufizuar.

Për qëllime të kësaj analize ne do ta analizojmë legjislacionin ekskluzivë për aftësinë e kufizuar në krahasim me nenin 9, të KDPAK, me theks të veçantë: *mjedisin fizik, transportin, informacionin dhe komunikimin dhe shërbimet publike*. Në këtë kontekst ne do ti trajtojmë më edhe disa dispozita tjera që në mënyrë indirekte kontribuojnë në qasshmëri dhe janë të ndërlidhura me aspektet krahasuese.

V.1.1 Mjedisi Fizik

Mjedisi fizik, sipas nenit 9, përfshin gjithçka që ofrohet për të gjithë qytetarët e tjerë në mënyrë që personat me aftësi të kufizuar të mund të jetojnë në mënyrë të pavarur duke u respektuar dinjiteti i tyre.

Rrugët, trotualet, qendra e qytetit, hapësirat publike, parqet, hapësirat rreth dhe në institucione publike,, qendrat shëndetësore, spitalet, vendet për rekreacion, objektet shkollore, edukative, kulturore, turistike, parkingjet, hyrjet në ndërtesa – janë vetëm disa nga komponentët që e përbejnë mjedisin fizik.

⁶¹ BE dhe HANDIKOS, Raport hulumtues, STANDARDET NDËRKOMBËTARE MBI ÇËSHTJET E AFTËSISË SË KUFIZUAR KU QËNDRON KOSOVA? Vlerësim i legjislacionit të Kosovës në lidhje me çështjet e aftësisë së kufizuar në raport me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, f.23 http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/05/Report_SHQ-29_04_20_95548.pdf.

Ligjet ekskluzivë për personat me aftësi të kufizuar kanë trajtuar ndaras komunitetin e personave me aftësi të kufizuar⁶², në bazë të llojit të aftësisë së kufizuar. Në këtë kuptim ne do ti prezantojmë analizat e dispozitave ligjore në bazë të këtyre ndarjeve duke i trajtuar çështjet e rregulluara sipas komponentëve të qasjes në kontekstin e të gjitha akteve ligjore të analizuara.

Mjedisi fizik, në bazë të kësaj ndarjeje nuk është trajtuar si fushë e veçantë. Gjithsesi, në mënyrë të përgjithshme dhe në kontekst të interpretimit, dispozitat ligjore me të cilat është garantuar barabarësia dhe mbrojtja nga diskriminimi në mënyrë të tërthortë i adresojnë edhe disa aspekte të mjedisit fizik.

Dispozitat ligjore të Neni 4⁶³, të dy këtyre ligjeve kanë garantuar mbrojtje për përfituesit e ligjit nga të gjitha llojet dhe format e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes, talljes dhe gëzimit të drejtave dhe lirive të tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Neni 4, i Ligji Nr. 05/L -067, ka specifikuar edhe më tej bazën ligjore të këtyre të drejtave dhe ka kërkuar që kjo mbrojtje të ofrohet bazuar në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të njohura nga Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut e me theks të veçantë me standardet dhe parimet e përcaktuara me Konventën Ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Një përcaktim pak më i orientuar në mjedisin fizik është pjesa e dispozitës ligjore me të cilën është kërkuar nga Institucionet përgjegjëse për miratimin e projekteve të infrastrukturës dhe rregullimin e territorit, të mos miratojnë asnjë projekt për rrugët dhe mjediset publike në qoftë se në to nuk janë marr parasysh përshtatjet e nevojshme dhe të mundshme për persona të verbër, Neni 15 par.1 [Përfitimet dhe të drejtat e tjera], Ligji nr. 04/L-92. Kjo dispozite ligjore i është drejtuar institucioneve përgjegjëse për rregullimin e mjedisit që nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji⁶⁴ duke kërkuar që miratimi i projekteve të infrastrukturës dhe rregullimit të territorit të kufizohet me plotësimin e kriterëve për përshtatjet e nevojshme për personat e verbër, në mënyrë të përgjithshme dhe pa i numëruar kriteret.

Megjithatë, organizatat e personave me aftësi të kufizuara⁶⁴ konsiderojnë se kërkesat e këtij ligji nuk janë zbatuar fare në praktikë ose vetëm pjesërisht në disa segmente dhe atë vetëm në zonën urbane, kryesisht në Prishtinë, sepse në qytetet e tjera të Kosovës edhe në zona urbane mungojnë përshtatjet në rrugët dhe mjediset publike. Ndërsa, zonat rurale janë të paprekura nga efekti i këtij apo ndonjë ligji tjetër të ngjashëm ashtu siç kërkohet nga neni 9 i KDPAK dhe Rekomandimet e Komitetit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar⁶⁵, që përshtatjet e mjedisit fizik duhet të përfshijnë zonat urbane dhe rurale.

⁶² Komuniteti i personave me aftësi të kufizuar si; personat e verbër, te shurdhër, paraplegjik, tetraplegjik, etj.

⁶³ LIGJI Nr. 04/L – 092 PËR PERSONAT E VERBËR dhe Ligji Nr. 05/L -067 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E PERSONAVE PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK.

⁶⁴ Grupi punues legjislativ për qasje, formuar për qëllim të kësaj analize.

⁶⁵ UN/CRDP/C/GC/2/ Committee on the Rights of Persons with Disabilities Eleventh session/ General comment No. 2 (2014)/ 22 May 2014, f.1, file:///C:/Users/FastTech/Downloads/CRPD_C_GC_2-EN.pdf.

Neni 3, [Përkufizimet], i Ligjit Nr. 03/L-19⁶⁶, në kontekst të realizimit të së drejtave për punësim, aftësim dhe riaftësim profesional ka specifikuar edhe më tej duke e përkufizuar *Përshtatshmëria e mjedisit – si masat e ndërmarrja me qëllim të sigurimit të një mjedisi pa barriera të natyrave të ndryshme për sigurim të qasjes së përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara; dhe përkufizimi për Mjetet ndihmëse - mjete të cilat i përdorin personat me aftësi të kufizuara, me qëllim të tejkalimit të pengesave të cilat e kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e zakonshme. Të dy këto përkufizime adresojnë çështjet mjedisore për personat me aftësi të kufizuara ndërsa pak ose fare pak ka rregullativë plotësuese ligjore për ta përcaktuar qartë se si do të duhej të duhej një mjedis i përshtatshëm dhe cilat janë ato mjete ndihmëse në referencë të mjedisit punues për persona me aftësi të kufizuara.*

Duke i definuar këto komponentë në funksion të qëllimit të këtij ligji, ka adresuar parakushtet themelore në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejtën e arsimimit sipas nenit 24 të KDPAK dhe të drejtën e punësimit sipas nenit 27 të Konventës sepse nënkupton se qasja në përgjithësi dhe mjedisi fizik në veçanti është i lidhur ngushtë edhe me të drejtat e tjera që dalin nga Konventa dhe se është parakusht për sigurimin, garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave që burojnë nga Konventa.

Mungesa e qasjes në mjediset fizike dhe përshtatja e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara ndikon drejtpërdrejtë në arsimimin dhe punësimin e këtij komuniteti. Edhe pse nuk ka statistika të sakta, organizatat e personave me aftësi të kufizuara ⁶⁷, në bazën e të dhënave që posedojnë, deklarojnë se shumë persona me aftësi të kufizuara nuk vazhdojnë shkollimin fillorë si shkollim i obliguar, edhe më pak vazhdojnë shkollimin e mesëm, ndërsa një numër shumë i vogël, vazhdojnë shkollimin universitarë. Ndërsa, punësimi edhe pse ky ligj kërcënon me gjobë punëdhënësit duke kërkuar që institucionet publike dhe private në Kosovë për çdo 50-të, të punësuar të kenë punësuar së paku një person me aftësi të kufizuara, edhe ky standard është ende larg për tu përmbushur. P. sh. Shoqata e të Verbërve të Kosovës, deklaroi se vetëm rreth 50 persona të verbër⁶⁸, janë të punësuar në të dy sektorët (publik dhe privat) ndërsa Shoqata e të Shurdhërve e Kosovës, deklaroi se komuniteti që konsiderohet gjysmë i shurdhër⁶⁹, kryesisht punojnë. HANDIKOS, deklaroi se janë diku rreth 150 persona me aftësi të kufizuara të punësuar në të dy sektorët (publik dhe privat).

Prandaj mund të konstatohet⁷⁰ se legjislacioni primar i Kosovës, vetëm pjesërisht i rregullon çështjet e mjedisit fizik, ndërsa edhe këto dispozita që në mënyrë të pjesshme e adresojnë këtë komponentë, nuk zbatohen plotësisht në praktike dhe përveç mungesës së

⁶⁶ LIGJI Nr. 03/L-019 PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA.

⁶⁷ Grupi punues legjislativ për qasje, 12.06.2023.

⁶⁸ Nga 2000 persona të verbër që janë të evidentuar në Kosovë, 1800 janë të përfshirë në skemat sociale për të verbër.

⁶⁹ Rreth 5000 persona të shurdhër jetojnë në Kosovë, 4997 konsiderohet si gjysmë të shurdhër, nuk janë të përfshirë në skemat sociale, por marrin shërbime të interpretimit, p.sh. gjate vitit 2023, janë dhënë 2700 shërbime të interpretimit që financohen nga fondet publike.

⁷⁰ Konstatimi është arritur në takimin e Grupit Punues Legjislativ për Qasje të datës 12.06.2023.

rregullativës së përgjithshme, mos zbatimi është sfidë në vete. Prandaj, nëse krahasohet në referencë të Nenit 9 të Konventës, konsiderohet se ka nevojë për një legjislacion të ri për referimin e mjedisit fizik dhe për mekanizma të zbatimit të legjislacionit aktual dhe atij që duhet të hartohet.

Mjedisit fizik, në mënyrë më të gjerë e ka trajtuar UA 33/2007⁷¹, i datës 18.06.2007, i cili buron nga Ligji NR. 2004/15, i vitit 2008⁷². Udhëzimi i trajton në mënyrë më të detajuar elementet e ndryshme të qasjes përfshirë edhe mjedisin fizik por është i kufizuar vetëm në fushëveprimin e aktit-objektet ndërtimore, ashtu që *Udhëzimi ka qëllim për të rregulluar kushtet teknike dhe mënyrën e sigurimit të qasjes së papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuara; modernizimin e qasjes në objektet e ndërtuara publike për destinim pune, banimi dhe banesor-afariste; si dhe kushtet dhe mënyra e përshtatshmërisë së thjeshtë të qasjes në objektin ndërtimor me destinim banimi dhe banesor-afarist (neni 1 i UA).* Synimi primar ishte rregullimi i elementeve të qasjes në institucione publike dhe në mjedise për destinim për publikun pa e përfshirë sektorin privat, deri tek kufizimet që lidhen me ofrimin e shërbimeve për publikun apo/ ose nëse janë të destinuara për publikun.

UA, kërkon që modernizimi dhe përshtatja e qasjes në objekte ndërtimore të ndodhë që nga procesi i projektimit, pastaj të materializohet gjatë realizimit të punëve në ndërtim ashtu që objektet ndërtimore të posedojnë elemente obliguese të qasjes dhe ti përmbushin kushtet për qasje për PAK. Përmbajtja obliguese e projektit, neni 54, për llojet e objekteve të përcaktuara në këtë udhëzim do të thotë përmbajtja e zgjidhjes teknike me të cilën caktohen elementet për qasje. Zgjidhja teknike paraqitet, varësisht nga niveli i punimit të projektit, në mënyrë të njëjtë si projekti ideor, projekti kryesor dhe projekti realizues i objektit ndërtimor.

Kërkesa tjetër lidhur me objektet ndërtimore është se ato duhet të posedojnë e lamente të qasjes edhe tek rrugët/hapësirat dalëse në rast rreziku. Ndërsa nga pronarët e atyre objekteve kërkohet të sigurohen për ti mirëmbajtur elementet e qasjes me qëllim që *mos të zvogëloj kushtet e përdorimit të mjeteve ndihmëse për lëvizje të PAK* përfshirë paraqitjen e informacionit, shenjave të qasjes me madhësi të përshtatshme dhe të vendosura në vendet e dukshme. Përfshirë, nëse për objektin e caktuar ndërtimor nuk është caktuar elementi i nevojshëm për qasje, atëherë kërkohet që së paku zgjidhja teknike e objektit ndërtimor duhet t'i plotësoj kushtet për përdorimin e mjeteve ndihmëse.

Obligimi për realizimin e elementeve të obliguara për qasje, sipas udhëzimit e kanë të gjithë ndërtesat publike me destinim pune, të numëruara në nenin 44, të këtij udhëzimi.

Me theks të posaçëm, udhëzimi e referohet :

Objekteve ndërtimore publike dhe administrative, dhe

⁷¹ UDHËZIMI ADMINISTRATIV-Nr. 33/2007 PËR KUSHTET TEKNIKE TË OBJEKTEVE NDËRTIMORE PËR QASJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA. (Shfuqizuar me Vendim të QRK, Nr. 02/50 të datës 23.12.2021) - (Mbetet në fuqi me Vendimi të QRK, Nr. 05/56 të datës 26.01.2022).

⁷² Aktualisht ky ligj është shfuqizuar me ligjin e ri për ndërtimin LIGJI NR. 04/L – 110 PËR NDËRTIM, ndërsa nëse krahasohen ligji i vjetër dhe UA 33/2007, konstatohet se UA është më e hershme se sa ligji, gjithsesi ky udhëzim është ende në fuqi sipas Vendimit të QRK, nr. 05/56, të datës 26.01.2022.

Objekteve ndërtimore të banimit dhe banesore -afariste.

Në kuadër të objekteve ndërtimore publike dhe administrative, udhëzimi ka numëruar rreth 15 kategori të këtyre objekteve të cilat e kanë të obliguar realizimin e elementeve për qasje (neni 44 i UA), pastaj i ka zbërthyer se cilat lloje të objekteve hyjnë në secilën kategori që përfshin një numër të madh të objekteve⁷³: *ndërtimet për shërbime tregtare, hoteliere dhe turistike; ndërtimet postare ose/dhe me destinim telekomunikacioni; ndërtimet për ofrim të shërbimeve të qarkullimit të parasë dhe shërbimeve tjera financiare; ndërtimet për qëllime administrative; ndërtimet për qëllime shëndetësore sociale dhe rehabilituese; ndërtesat në të cilat më së shpeshti qëndrojnë PAK; ndërtimet e dedikuara për edukim dhe arsim; ndërtimet e dedikuara për kulturë; ndërtimet e dedikuara për komunikacion; ndërtimet e dedikuara për sport dhe rekreacion; ndërtimet për shërbime fetare dhe sakrale: ndërtimet e dedikuara për argëtim; ndërtesat për vuajtjen e dënimeve me burg; sipërfaqet dhe hapësirat publike; dhe ndërtimet tjera, ku hyjnë : panairët dhe qendrat e ekspozitave, Tualetet publike, ndërtimet të cilat duhet të kenë 4 e më shumë njësi tualetesh, morgu dhe krematori, strehimorja publike dhe të ngjashme.*

Në kuadër të grupit të dytë - objektet ndërtimore banesore dhe banesore -afariste janë përfshirë:

- 1) *Objekti banesore me dhjetë e më shumë banesa, ekskluzivisht me destinim banimi.*
- 2) *Objekti banesor-afarist që është objekt me destinim banimi dhe destinime tjera, që ka dhjetë apo më shumë banesa.*

Në rastin kur këto objekte janë me destinim publike, udhëzimi obligon pronaret për sigurimin e elementeve të qasjes varësisht nga destinimi i punës në atë pjesë. Ashtu edhe nëse në objektin ndërtimor me destinim banimi gjendet hapësira publike për qëllime afariste atëherë në atë ndërtesë, varësisht nga lloji i aktivitetit i cili kryhet në atë hapësirë, duhet të aplikohen të gjitha elementet e qasjes.

Kërkesat e udhëzimit për aplikimi adekuat të elementeve të qasjes janë kusht për përdorimin e mjeteve ndihmëse të përcaktuara në nenin 6, të këtij udhëzimi, e që nënkupton: *hapësira e nevojshme për lëvizje të PAK me karro cë; hapësira e nevojshme për përdorimin e shkopit, patericës, mjetit ndihmës për ecje, dhe hapësira e nevojshme për përdorimin e shkopit të bardhë dhe qenit përcjellës.*

UA 33/2007, ka kategorizuar *Elementet obliguese për qasje*, në 3 lloje:

1. *Elementet për qasjen në nivele me lartësi të ndryshme (rampa, shkallet, ashensorët, platforma ngritëse vertikale, platforma e pjerrët ngjitëse palosëse);*
2. *Elementet e qasjes për jetë të pavarur (hapësira hyrëse, komunikimi, ËC, kabina për pastrim, kuzhina, dhoma, klasa, hapësira e punës, banesa, kafenetë dhe restorantet, gardërobat, dush kabina, hyrja në ujë në pishinë, vendet në tribuna, telefonat, tekstafon, faks, bankomatët, instalimet elektrike, dorëza e derës dhe e dritareve, sportel, pulti, tabela e shpalljeve dhe ekspozitave, plani për orientim të lëvizjes në ndërtesa dhe të ngjashme);*

⁷³ UA 33/2007, neni 5.

3. Elementet për qasje në komunikacion publik (*vend ndalja dhe peroni, vend parkingu, sipërfaqet publike për këmbësorë, semafori, vendkalimi i këmbësorëve, ishujt e këmbësorëve dhe udhëkryqet*).

Ndërsa, *Sipërfaqja taktore e qasjes* ka të bëjë me realizimin e punimeve relievore në lartësi deri 5 mm në mënyrë që të mos vështirësoj lëvizjen e PAK me karrocë, të jetë e njohur me prekjen e shputës ose me shkop të bardhë, të mos qëndroj uji, bora dhe mbeturinat, si dhe të mirëmbahet lehtë.

Elementet e qasjes për të cilat u diskutua më lartë, kërkohen edhe për pjesët e objekteve ndërtimore publike me destinim pune të përcaktuar në udhëzim të cilat rindërtohen ose do të rindërtohen.

Heqja dorë nga elementet e përcaktuara për qasje mund të bëhet vetëm përjashtimisht dhe atë vetëm ashtu siç është parapare në Neni 52, të këtij udhëzimi, *në rastet e rindërtimit të objektit ndërtimor publik dhe administrativë i cili ndodhet në tërësi urbanistike e cila është e regjistruar në regjistrin e monumenteve kulturore të Kosovës, nuk mund të sigurohen elementet e përcaktuara të qasjes, të parapara që të mos prishen vlerat e monumentit kulturor, është e lejuar përjashtimisht heqja dorë nga elementet e përcaktuara për qasje, me kusht që për heqjen dorë të sigurohet pëlqimi i MMPH –së, dhe së bashku me propozimin për pëlqim nga MMPH duhet të bashkëngjitet edhe mendimi i organit kompetent për mbrojtjen e monumenteve kulturore për shkatërrimin e vlerave të objekteve kulturore të cilat do të ndodhnin me rastin e realizimit të zgjidhjes teknike të projektuar për qasjen në objektin ndërtimor.*

Me qëllim të lehtësimit për identifikimin e elementeve të qasjes dhe standardeve për këto elemente, UA, në pjesën e fundit në shtojcën⁷⁴, ka prezantuar me foto elementet e ndryshme të qasjes të cilat mund të projektohen në objekte të reja apo të adaptohen në objektet ekzistuese.

Megjithëse, UA 33/2007, e ka plotësuar mungesën e dispozitave ligjore për qasjen në përgjithësi dhe mjedisin fizik në veçanti në legjislacionin primar, prapë së prapë, rekomandohet⁷⁵ që ky udhëzim ose me saktësisht përmbajtja e këtij udhëzimi të bëhet ligj. Paraprakisht, duhet të plotësohet dhe rregullohet përmbajtja në mënyrë që të adresohen të gjitha elementet e qasjes, përfshirë pa u kufizuar mjedis fizik, transportin, informimin dhe komunikimin dhe shërbimet publike. Me tutje, ligji t ë plotësohet me udhëzime dhe rregullore që përmbajnë kërkesa praktike edhe për arsyen se baza ligjore e këtij udhëzimi është e diskutueshme.

⁷⁴ UA 33/2007, SHTOJCA PARAQITJA E FOTOGRAFIVE ME SHENJA QASËSE, KUSHTET E PËRDORIMIT TË ELEMENTEVE ND IHMËSE PËR QASJE, f. 34.

⁷⁵ Grupi punues legjislativë për qasje, 12.06.2023.

V.1.2 Transporti Publik

Transporti publik, në kontekst të Nenit 9, të KDPAK, dhe standardeve tjera të fushës, ka të bëjë me:

mjetet e përbashkëta publike të transportit (trenat, autobusët, aeroplanët, varkat, tramvajet, etj.); mjetet e përgjithshme për transport individual (taksitë, furgonët, etj.); objektet ndihmëse që lidhen me transportin (stacione, stacione autobusi, aeroporte, etj.); infrastruktura urbane që lidhet me lëvizshmërinë (rrugë, ura, vendkalime për këmbësorë, trotualet, etj.); informimi dhe komunikimi brenda objekteve ndihmëse të përbashkëta (tabelat në stacionet e autobusëve, oraret, hartat, informacionet për udhëtarët në aeroporte, etj.); informacioni dhe komunikimi brenda mjeteve kolektive të transportit (informacione të qasshme brenda tramvajeve, trenave, autobusëve, etj., për ndalesat aktuale dhe të ardhshme, procedurat e urgjencës, si të telefononi t për ndihmë, etj.); informacioni dhe komunikimi dixhital (Platforma dixhitale që ofrojnë në kohë reale informacion mbi sistemin e transportit, shërbimet e internetit për të rezervuar një biletë ose procedurat për ankesë, etj.).

Të gjitha këto fusha, pa u përkufizuar vetëm në to, për të gjitha zonat urbane dhe rurale, shtoj se në rekomandimet e Komitetit, përgjegjësia zgjerohet jo vetëm për institucionet publike por edhe ato private që kryejnë shërbime në funksion të publikut.

Njësoj si në rastin e mjedisit fizik, edhe dispozitat të cilat iu referohen transportit publik janë të shpërndara dhe të fragmentuara nëpër ligje që trajtojnë aspekte të përgjithshme të kategorive të personave me aftësi të kufizuar dhe janë larg standardeve të kërkuara të Nenit 9, të Konventës lidhur me transportin publik, posaçërisht në pjesën e zbatimit. Edhe pse viteve të fundit në Kosovë, në të gjitha zonat urbane ka pasur ndërhyrje në infrastrukturën rrugore dhe banesore, janë të rralla rastet p.sh kur janë zbatuar specifika të teknike apo elementet e qasjes që lidhen me lëvizshmërinë e personave me aftësi të kufizuar.

Në referencë të transportit publik dhe me qëllim të krijimit të lehtësirave, Ligji për Personat e Verbër, neni 13 dhe Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, me nenin 15 e ka normuar komponentin e udhëtimit për personat me aftësi të kufizuar-përkatesisht personat e verbër, personat me dëmtime fizike dhe shoqëruesve respektivisht kujdestarët e tyre për të cilët ka siguruar lirime nga pagesa në trafikun urban, ndërsa lirim për 50 % të vlerës së biletës në trafikun ndër urban. Gjithashtu, me këtë nen janë obliguar operatorët privat dhe publik për përcaktimin e vendeve për të verbrit dhe vendosjen e sinjaleve përkatëse, në raport me përfitimet e lirit nga detyrimi fiskal.

Organizatat e personave me aftësi të kufizuar⁷⁶, në referencë të kësaj garancie ligjore, kanë deklaruar se këto dispozita gjejnë zbatim të plotë kur është fjala për trafikun publik urban, kryesisht në Prishtinë, ndërsa tek trafiku ndër urban nuk zbatohen. Për më shumë, në vise tjera urbane dhe rurale nuk zbatohen fare ose zbatohen vetëm pjesërisht në disa lokacione. Theksojnë se në autobusët e trafikut urban ka disa vende të shënuara në alfabetin Brail, ka

⁷⁶ Grupi Punues Legjislativ për qasje, datë 12.06.2023.

vende-hapësira dhe sinjalizime për paraplegjik dhe tetraplegjik por kjo qëndron vetëm për autobusët e rijnë dhe vetëm në Prishtinë. Situata në vendet e tjera nuk është e njëjtë. Zakonisht për të vërtetuar statusin e personit me aftësi të kufizuar, personat paraqesin librezat e aftësisë së kufizuar. Megjithatë, edhe shfrytëzimi i kësaj garancie ligjore mbetet i vakët për shkak të mungesës së infrastrukturës tjetër ndihmëse që do ti mundësonte personat me aftësi të kufizuar ti gëzonin përfitimet e lirimit në udhëtim.

UA 33/2007, në anën tjetër në mënyrë më specifike i ka normuar çështjet që lidhen me transportin publik dhe është përpjekur përmes shtojcës së udhëzimit të jep disa specifika teknike lidhur me kërkesat për *Elementet për qasje në komunikacionin publik*, neni 36, që janë: *vend ndalja dhe peroni, vend parkingu, sipërfaqet publike për këmbë sorë, semafori, vendkalimi i këmbësorëve, ishujt e këmbësorëve dhe udhëkryqet, duke i rregulluar për secilin elemente kërkesat për standardizimin e këtyre elementeve në mënyrë që të jenë të qasshme për personat me aftësi të kufizuar.*

Gjithsesi, kur flasim për gjendjen faktike në transport, personat me aftësi të kufizuar në vazhdimësi kanë potencuar se mjetet motorike që qarkullojnë në komunikacionin publik, jo gjithëherë janë të pajisur me elemente që mundësojnë qarkullimin e personave me aftësi të kufizuar. Disa nga mjetet janë të vjetra dhe tek disa tjera mungojnë elementet kryesore të qasjes në transportin publik, përfshirë por pa u kufizuar në elementet përkatëse për mjete qarkulluese dhe elementet e tjera ndihmëse që lidhen me transportin në përgjithësi. Kjo nënkupton në të shumtën e rasteve sistemi i *transportit (rruga, trotuari, vend ndalja, barrierat, mungesa e rampave, etj.)* është i pa qasshëm për personat me aftësi të kufizuar dhe kjo është njëra nga arsytet që personat me aftësi të kufizuar janë privuar nga gëzimi i të drejtave elementare siç janë arsimit, shëndetësia, punësim dhe të drejtave të tjera që ndërliken me qasjen e pakufizuar në transport dhe në raste të domosdoshme janë ballafaquar me shpenzime shtesë në udhëtime. Neni 9 i KDPAK, kërkon evidentimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave, ndër të tjera edhe në rrugë, në transport dhe në infrastrukturën tjetër ndihmëse dhe kjo nuk kufizohet vetëm tek transporti publik por të gjithë operatorët që janë venë në funksion të shërbimeve ndaj publikut, e të cilët janë të obliguar të krijojnë qasje të papenguar në të gjitha mjetet me destinim për publikun.

Në mënyrë të patjetërsueshme kjo lidhet direkt me gëzimin e të drejtës për shkollim, sepse Komiteti⁷⁷, ka konstatuar se *'pa transport të qasshëm për në shkollë, ndërtesa të qasshme, informata dhe komunikime të qasshme, personat me aftësi të kufizuar nuk do të kenë mundësi që të ushtrjnë të drejtën e tyre për shkollim'* (të garantuar me nenin 24 të KDPAK), e garantuar gjithashtu edhe me Kushtetutën e Kosovës dhe një varg të gjerë të drejtave të tjera.

⁷⁷ UN/CRDP/C/GC/2/ Committee on the Rights of Persons with Disabilities Eleventh session/ General comment No. 2 (2014)/ 22 May 2014, f. 11.

V.1.3 Informimi dhe Komunikimi (përfshirë shërbimet e ofruara nga media publike (TV, radio) dhe Interne

Neni 9, i KDKPAK, i referohet Informacionit, komunikimit dhe shërbimeve të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe ato të urgjencës, por nuk kufizohet vetëm në këto, sepse përfshinë ndër të tjerat edhe teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) si arritje moderne e zhvillimit aktual.

TIK- është term ombrellë që përfshin çdo pajisje ose aplikacion informacioni dhe komunikimi dhe përmbajtjen e tij, që përveç tjerash përfshinë edhe qasjen në një gamë të gjerë të teknologjive siç janë: radio, televizion, satelit, telefona celularë, linja fikse, kompjuterë, pajisje dhe softuer të rrjetit, internetit.

Ndërsa, Komunikimi-përfshin gjuhët, shfaqjen e tekstit, shkrimin Braille, komunikimin me prekje, shtypjen me madhësi, multi-median e qasshme dhe të shkruar, audio, në gjuhë të thjeshtë, mënyra njerëzore të komunikimit verbal dhe jo -verbal, mjetet dhe formatet e komunikimit, duke përfshirë teknologjinë e qasshme të informacionit dhe komunikimit⁷⁸. Gjithashtu, tek ky komponent, hyjnë edhe mjetet e dizajnit universal edhe në referencë të qasjes, për realizimin e të drejtave të garantuara, por posaçërisht për realizimin të drejtës në arsim, që mund të jenë një temë për analizë të veçantë. Në referencë të sektorit të informacionit dhe komunikimit, situata lidhur me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushe është njësoj sikur me fushat e tjera.

Ligji për personat e verbër në nenin 11 [Qasja në informacion], e normon kërkesën që Personave të verbër u mundësohet informimi në brail, në relief, shkrim të zmadhuar, si dhe në audio për të gjithë sinjalizimin në ambientet publike, informacionet publike zyrtare, literaturën, tekstet dhe librat në të gjitha nivelet shkollore në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës, duke e bartur përgjegjësinë për zbatimin tek Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës dhe Ministria e infrastrukturës (neni 11 par. 2). Mirëpo nuk ka dispozita tjera apo akte tjera të cilat e rregullojnë procedurën se si do t ë zbatohen këto dispozita.

Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Persona ve Paraplegjik dhe Tetraplegjik i referohet kësaj fushe në kontekst të Lirisë së të shprehurit dhe mendimit, si dhe qasja në informacion, Neni 6, duke garantuar të drejtën për të shprehur mendimet e tyre përfshirë lirinë për të kërkuar, marrë dhe përhapur informacionin dhe idetë në baza të barabarta me të tjerët dhe nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit sipas zgjedhjes së tyre.

Udhëzimi Administrativë Nr. 33/2007, edhe pse nuk e ka burimin nga ligjet e sipërhënuara për në funksion të informimit ka adresuar [Planin orientues për lëvizje në ndërtesa], Neni 35, përmes së cilës kërkon që plani orientues për lëvizje në ndërtesë duhet të jetë i realizuar në formë relievo që të plotësoj kushtet ashtu që: të jetë i vendosur horizontalisht deri në lartësi prej 90 cm, gjegjësisht vertikalisht deri në lartësi prej 180 cm ; të jetë i vendosur pranë hyrjes në ndërtesë; të përmban informata në shkrimin Braille; prej derës hyrëse të ndërtesës

⁷⁸ Council of Europe, Anna Lawson, Accessibility of information, technologies and communication for persons with disabilities Contribution to the Council of Europe Strategy on the Rights of Persons with Disabilities, f.11; f. 16, <https://rm.coe.int/final-study-accessibility-of-information/168072b420>.

deri te plani të ketë vijë taktore drejtuese nga kahja e lëvizjes; të shënohet me shenjë të qasshme sipas fig.1. adekuate të shtojcës së këtij Udhëzimi Administrativ.

Rregullorja e QRK Nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës, është nxjerrë në funksion dhe me qëllim të rregullimit ligjor të komponentës së informimit dhe komunikimit të personave të shurdhër duke përfshirë edhe informimin përmes mediave-televizionit publik ka specifikuar mënyrën e dhënies së shërbimeve për gjuhën e shenjave për personat e shurdhër nga ana e institucioneve publike në nivel nacional dhe në nivel lokal. Rregullorja gjithashtu ka përcaktuar edhe përgjegjësinë për financimin e shërbimeve, trajnimin dhe certifikimin e Interpretëve të gjuhës së shenjave, publikimin e informacionit dhe përgjegjësinë për zbatim.

Me anë të rregullores është përcaktuar: *Koordinimi në ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave dhe ; Procedura për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave për personat e shurdhër dhe për institucionet publike, ndërsa ka garantuar se Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim në baza vjetore do të ndajë mjete financiare për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave për të gjithë vendin.*

Gjithashtu, rregullorja ka adresuar edhe trajnimet dhe certifikimin e Interpretëve të gjuhës së shenjave me qëllim që vetëm interpretët e gjuhës së shenjave të akredituar të mund të ofrojnë interpretim në gjuhën e shenjave në mënyrë institucionale dhe zyrtare.

Me qëllim të informimit dhe lehtësisë së komunikimit për persona të shurdhër, *Publikimi dhe informimi*, Neni 17 ka kërkuar nga ZQM dhe SHKSH krijonë "lidhëse" të veçantë në ueb faqet e tyre institucionale dhe të publikojnë edhe në gjuhën e shenjave këtë rregullore; *formularin për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave; udhëzuesin për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave; dhe, të gjitha materialet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të gjuhës së shenjave për personat e shurdhër dhe për institucionet.*

Kjo rregullore, përgjegjësinë për monitorim dhe zbatim të kësaj rregulloreje në nivel qendror dhe lokal e ka deleguar tek ZQM (neni 19).

Ndërsa, komponentët e tjera të kërkesës për qasshmërinë në reference të nenit 9, të KDPAK nuk janë adresuar në këtë pjesë të legjislacionit që i referohet personave me aftësi të kufizuar, ndaj ky aspekt duhet të trajtohet me kornizën e re ligjore të harmonizuar me KDPAK.

V.1.4 Shërbimet Publike

Shërbimet publike në kontekst të Nenit 9, të KDPAK, dhe standardeve tjera ndërkombëtare janë të gjëra, në kuptimin që përfshinë një tërësi burimesh me të cilat synohet të mbështetën personat në një shoqëri apo komunitet.

Në shërbime publike hyjnë por nuk kufizohen; kujdesi shëndetësor, edukimi/arsimi, energjia, shërbimet ligjore, telekomunikacioni, shërbimet e transportit dhe infrastrukturës së transportit, planifikimi urban, shërbimet e emergjencës, furnizimi me ujë, mbrojtja e ambientit, shërbimet sanitare, shërbimet postare, shërbimet e rekreacionit, programet ekonomike dhe të agrikulturës, shërbimet sociale, ndërtesat publike, etj.

Shërbimet publike janë fusha më e shpërndarë për tu hulumtuar në kontekstin e personave me aftësi të kufizuara. Në ligjet e listuar për analizë gjejmë dispozita ligjore që i referohen çështjeve të ndryshme lidhur dhe për shërbimet publike, gjithsesi edhe këto dispozita që ekzistojnë, fare pak dhe vetëm pjesërisht zbatohen në praktikë.

Kujdesi shëndetësor- në dispozitat ligjore të Ligjit për personat e verbër Neni 9, është përcaktuar se *shërbimet shëndetësore themelore ofrohen në cilësi dhe sasi të njëjtë si për të gjithë qytetarët ndërsa shërbimet mjekësore të cilat ju ofrohen personave të verbër, të cilët nuk paguajnë premiumet do të rimbursohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi për Sigurime Shëndetësore*. Gjithsesi, në Kosovë nuk ka sigurime shëndetësore edhe pse një ligj për këtë çështje ka që nga viti 2014.

Ndërsa Ligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, Neni 13, ka garantuar *lirimin nga pagesa e premiumit dhe çfarëdo pagese tjetër shtesë në sistemin shëndetësor publik*. Gjithashtu, ligji i ka adresuar edhe grupin e personave të cilët nuk kanë mundësi për tu paraqitur në institucione shëndetësore publike duke garantuar *përfitim* e shërbimit shëndetësor shtëpiak nga profesionisti shëndetësor i licencuar, mjeku i familjes dhe mjeku specialist për ato shërbime mjekësore që mund të kryhen në mënyrë ambulatorë dhe në kushte shtëpie.

Mbi bazën e këtij ligji është hartuar edhe *Lista dhe llojet e pajisjeve ndihmëse falas për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, që shërbejnë për lëvizje, parandalim dhe asistim*⁷⁹, akt i cili është aprovuar, por që ende nuk ka hyrë fuqi, ndërsa *Institucionet kompetente ofrojnë rehabilitim shëndetësor, fizik dhe social për përfituesit e këtij ligji sipas vlerësimit të komisionit vlerësues*, edhe këto dispozita nuk zbatohen për faktin se institucionet kompetente ose nuk kanë përvojë ose nuk kanë ekspertë ose nuk janë të pajisur me mjete dhe njohuri për punën me persona me aftësi të kufizuara⁸⁰. Gjithsesi, ligji e përcakton Ministrinë e Shëndetësisë përgjegjëse për zbatimin e këtyre dispozite.

Ligji për Personat e Verbër e ka adresuar çështjen e ndërtimit të qendrave të rehabilitimit neni 12, duke e përcaktuar se *Qeveria përcakton fonde për ndërtimin e qendrave të rehabilitimit, me kapacitet të mjaftueshëm për personat e verbër, ndërsa Administrimi i qendrave të rehabilitimit, bëhet me autorizimin e Ministri së përkatëse në bashkëpunim me Shoqatën për Personat e Verbër të Kosovës*.

Kompensimet - Pensionet- E drejta për pensionet e aftësisë së kufizuara të financuara nga buxheti shtetëror është garantuar me Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti në të cilin personat me aftësi të kufizuara janë të përkufizuar si komunitet për përfitim sipas skemës së pensioneve të aftësisë së kufizuara. Kompensimet si mjete për lehtësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuara, në Ligjin për statusin dhe të drejtat e personave

⁷⁹ UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 11/2022 PËR ÇAKTIMIN E LISTËS, LLOJEVE DHE PAJISJEVE NDIHMËSE QË OFROHEN FALAS PËR PERSONAT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK QË SHËRBEJNË PËR LËVIZJE, PARANDALIM DHE ASISTIM, 28 Nëntor 2023/ Neni 15..

⁸⁰ Grupi punues legjislativ për qasje, anëtarët e HANDIKOS, datë 06.07.2023.

paraplegjik dhe tetraplegjik, pavarësisht nga mosha Neni 7, ka garantuar një kompensim në një shkallë të caktuar nga buxheti shtetëror, bazuar në pagën minimale në Kosovë⁸¹, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, personat të cilët kanë pasoja të përhershme dhe të plota në inkontinencë, përdorin medikamente në baza ditore, kanë humbje të ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të plagëve dekubitare marrin një shumë shtesë prej pesëdhjetë për qind (50%) të kompensimit nga shkalla e caktuar. Ligji ka deklaruar se Punësimi, vetëpunësimi apo ndonjë formë tjetër e punësimit, nuk do të jenë arsye për përjashtim nga kompensimi, siç përcaktohet në këtë ligj. Ligji për Personat e Verbër Neni 7, Të ardhurat dhe përfitimet, ka përcaktuar se Personat e verbër pavarësisht nga mosha të përcaktuar me këtë ligj, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo më pa se njëqind (100) Euro në muaj, që përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Qeveria. Për pagesën e pensioneve përgjegjësia bije tek Departamenti i Administratës së Pensioneve në kuadër të Ministrisë përkatëse (MPMS). Ligji i ka përjashtuar nga përfitimi i këtij kompensimi personat të cilët gjinden në institucione nën përkujdesjen shtetërore.

Kompensimet për kujdestar-shoqërues – personave të verbër dhe shoqëruesve të personit të verbër i cili është kategorizuar në grupin e parë, ligji u garanton kompensim, pasi të jetë e përcaktuar nevoja për shoqërues nga Komisioni Mediko-social.

Ndërsa, për persona paraplegjik dhe tetraplegjik Neni 8, edhe kujdestarëve personal të tyre, qoftë të zgjedhur nga përfituesi i këtij ligj i, qoftë i zgjedhur nga organi i kujdestarisë, kompensim me shumën e njëjtë sikurse përfituesi i kompensimit. Fondet për pagesa të kompensimit dhe kujdestarit (Neni 9) sigurohen nga buxheti i përgjithshëm i MPMS dhe pagesa bëhet në baza mujore nga Departamenti për Pensione në kuadër të MPMS.

Arsimimi dhe edukimi– për personat e verbër në institucione publike garanton sigurimin e përdorimit të shkrimit Braille, shkrimit relievor, shkrimit me shkronja të zmadhuara dhe tekstet në teknikën akustike dhe digjitale nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Nga ku obligohet MPMS, MASHT dhe Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës për sigurimin dhe shpërndarjen e pajisjeve tiflo-teknike dhe tiflo-didaktike të cilat lehtësojnë integrimin e personave të verbër në shoqëri. Megjithatë, Komuniteti i personave të verbër, deklarojnë se ky nen nuk zbatohet në mënyrë të plotë sepse në shkolla në të gjitha nivelet e arsimit mungojnë mjetet ndihmese (pajisjet tiflo-teknike dhe tiflo-didaktike) përfshirë edhe materiali i përshtatshëm për mësim-nxënie për personat e verbër⁸².

Persona paraplegjik dhe tetraplegjik, neni 12 i ligjit specifik u garanton arsimimin në institucionet publike dhe private sipas legjislacionit në fuqi, duke u njohur të drejtë për shkollim pa pagesë në të gjitha nivelet e shkollimit në institucionet publike dhe strehimin në konviktet publike. Në referencë të qasjes, dispozita ligjore e nenit 12 par 3, kërkon që MASHT në bashkëpunim me MMPH dhe komunat të ndërmarrin të gjitha masat me qëllim që të gjitha institucionet shkollore dhe Universitetet qoftë ato private apo publike të sigurojnë

⁸¹ Kompensimi në bazë të shkallës së paaftësisë: familjet për fëmijë me AK marrin 100 Euro; PAK-pensionet e AK, 100 Euro; Te verbrit 125 Euro + shoqëruesit 125; Paraplegjiket dhe tetraplegjiket 150 Euro+ kujdestari 150 Euro+ 75 Euro për material për inkontince dhe plage dekubitare; ndërsa grupi i dytë i tyre 150 euro

⁸² Grupi punues legjislativ për qasje, datë 06.07.2023.

*kushte dhe standarde teknike të objekteve për qasje dhe qëndrim të përdoruesve të karrocave në pajtim me legjislacionin përkatës për ndërtimet. Megjithatë, pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuar është shumë e vogël në të gjitha nivelet e arsimit, fillimisht për shkak të mungesës së qasjes fizike për këtë komunitet të personave me aftësi të kufizuar dhe më pastaj sidomos në arsimin e lartë edhe për shkak të kushteve materiale*⁸³.

Strehimi – Ligji për Personat e Verbër Neni 8, në dispozitën ligjore ka garantuar se *t ë verbrit që plotësojnë kushtet ligjore për t'u konsideruar si qytetarë me nevojë për strehim, në përfundim të vlerësimit të nevojës së tyre përfitojnë një shtesë prej njëzet (20) pikash, mbi masën e vlerësuar.* Gjithsesi, sipas shoqatës së të verbërve, nuk ka ndonjë evidencë apo shembull praktikë se kjo dispozitë të jetë zbatuar në praktike⁸⁴. Ligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik , *personat që plotësojnë kushtet ligjore për t'u konsideruar si qytetarë për strehim, në përfundim të vlerësimit të nevojës së tyre, përfitojnë strehimin familjar në ndërtimet e objekteve kolektive të banimit social. Në vazhdimësi kërkohet nga Organet kompetente të pushtetit lokal t'ju japin përparësi zgjidhjes së kërkesave të personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik për strehim, duke pasur parasysh kushtet, veçoritë dhe gjendjen shëndetësore të tyre.*

Lirimi nga taksat dhe tatimet – Personave të verbër sipas ligjit specifik u garantohet *lirimi nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë.* Duke siguruar mbrojtje edhe në rast vetëpunësimi ata lirohen nga çdo detyrim fiskal, ndërsa në rast se zhvillojnë veprimtari si persona juridikë, ata gëzojnë lehtësira tatimore të cilat i realizojnë sipas li gjeve në fuqi. Ndërsa, personat paraplegjik dhe tetraplegjik, Neni 10 i ligjit specifik, *lirohen nga taksat për regjistrim të automjetit personal apo të kujdestarit.* Gjithashtu, *përfituesit e këtij ligji lirohen nga taksat për dokumente personale dhe certi fikata të gjendjes civile.*

Shpenzimet e energjisë elektrike dhe telefonit – Personat e verbër në bazë të dispozitës ligjore të Neni 14, të Ligjit për Persona të Verbër , *gëzojnë lehtësira në konsumin e energjisë elektrike sipas Ligjit të Skemës Sociale. Qev eria siguron që të gjithë të verbrit të grupit të parë të pajisen me softuer folës asistues për të verbëritë. Ndërsa personat nga, Ligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik , Neni 14, gëzojnë reduktim në tarifa të konsumimit të energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara nga organet kompetente.*

Infrastruktura dhe territori – Ligji për personat e verbër në Nenin 15, posedon një dispozitë ligjore *[Përfitimet dhe të drejtat tjera],* përmes së cilit i garanton përfituesit e këtij ligji se *Institucionet përgjegjëse për miratimin e projekteve të infrastrukturës dhe rregullimin e territorit nuk miratojnë asnjë projekt për rrugët dhe mjediset publike në qoftë se në to nuk janë marrë parasysh përshtatjet e nevojshme dhe të mundshme për persona të verbër.* Gjithashtu, ligji garanton edhe përparësi në shërbime publike me theks të veçantë në zgjidhjen e kërkesave .

⁸³ Grupi punues legjislativ për qasje, datë 06.07.2023.

⁸⁴ Komunikimi me email me SHVK, datë 10 gusht 2023.

Dispozita ligjore që lidhen direkt dhe indirekt me shërbime publike, në tendencë për të mandatuar institucionet arsimore, zyrat e punësimit, qendrat e aftësimin profesional, dhe personat tjerë juridik, të cilët i plotësojnë kushtet për arsim dhe aftësim profesional për të zhvilluar *politika qeveritare* për aftësim, riaftësim profesional për personat me aftësi të kufizuar me qëllim të krijimit të kushteve për punësimin e personave me aftësi të kufizuar, ka edhe në Ligjin për Aftësimin, Riaftësimin Profesionale dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe në plotësim ndryshimin e këtij ligji, Neni 8; Neni 10.

Ndërsa në lidhje me garantimin e të drejtës së punësimit Neni 12, *[Punësimi në tregun e hapur të punës]*, ka obliguar *Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës ti punësojnë personat me aftësi të kufizuara. Duke obliguar çdo punëdhënës të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.*

Punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, obligohet që për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara të paguaj në buxhetin e Kosovës kontribute mujore në lartësi prej shumës së pagës minimale.

Udhëzimi Administrativë 33/2007, nuk i ka adresuar shërbimet publike për nga përmbajtja e tyre, por duke i adresuar elementet për qasje dhe komponentët ndihmëse të qasjes ka prekur çështje që ndërlidhen me shërbimet publike dhe sidomos tek objektet infrastrukturore publike dhe administrative dhe të gjithë të tjerat që janë me destinim publik, pa u kufizuar në: *ndërtimet për shërbime tregtare, hoteliere dhe turistike; ndërtimet postare ose/dhe me destinim telekomunikacioni; ndërtimet për ofrim të shërbimeve të qarkullimit të parasë dhe shërbimeve tjera financiare; ndërtimet për qëllime shëndetësore sociale dhe rehabilituese; ndërtimet e dedikuara për edukim dhe arsim; ndërtimet e dedikuara për kulturë; ndërtimet e dedikuara për komunikacion; ndërtimet e dedikuara për sport dhe rekreacion; ndërtimet për shërbime fetare dhe sakrale; ndërtimet e dedikuara për argëtim; ndërtesat për vuajtjen e dënimeve me burg; sipërfaqet dhe hapësirat publike, etj.*

Aspekte të ndryshme si nga aspekti sasior dhe i kualitetit lidhur me shërbime publike duhet të jenë pjesë e legjislacionit të rishikuar në funksion të harmonizimit me kërkesat e KDPAK.

V.2 PJESËMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE

Në aspektin e të drejtave të njeriut dhe KDPAK, Neni 29, pjesëmarrja në jetën publike dhe politike ka të bëjë, pa u kufizuar me: të drejtën për të marrë pjesë në votime, për të marrë pjesë aktive në procesin zgjedhur dhe për të qenë kandidat për tu zgjedhur, të drejtën për mbajturi poste dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes, të drejtën për pjesëmarrje në organizata joqeveritare dhe të përfaqësimit të organit të shtetit, përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale. Jo vetëm numërimi i këtyre të drejtave në aspektin formal është i rëndësishëm, por edhe materializimi i këtyre të drejtave, p.sh. për tu realizuar drejta e votimit, institucionet përgjegjëse e kanë për detyrë që gjatë procesit të votimit të sigurojnë procedurën dhe materialet të cilat janë të arritshme dhe të kuptueshme për personat me aftësi të kufizuar, që teknologjia e re të jetë e përdorshme për personat me aftësi të

kufizuar, të sigurohet shprehja e vullnetit të lirë të tyre, të ofrohet ndihmë gjatë procesit të votimit nga një person i zgjedhur prej tyre, vendvotimet të jenë të qasshme dhe aspekte të tjera që e maksimizojnë realizimin e të drejtës për të votuar. Gjithashtu, pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuar në jetën publike dhe politike pa diskriminim, përfshirë pjesëmarrjen në OJQ, shoqata, parti politike dhe organizata që synojnë të nxisin përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuar në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtarë.

Fjalët kyçe:

Pjesëmarrjen në votime; Pjesëmarrje në zgjedhje; Përfaqësim në institucione publike ;Pjesëmarrje në organizata joqeveritare dhe përfaqësim i organizatave; Përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.

Në referencë të pjesëmarrjes në votime, si e drejtë themelore dhe kushtetuese, nga raportet dhe deklaratat përfundimtare të organizatave të cilat merren me monitorimin e zgjedhjeve në Kosovë, rezulton se me gjithë përparimet që janë bërë, konsiderohet se ende ka nevojë të punohet për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në procesin zgjedhor, përfshirë edhe fushatat e partive politike dhe pjesëmarrjen në votime në ditën e zgjedhjeve.

Një përfundim që ka dhënë Misioni Vëzhgues i BE-së për Zgjedhjet Komunale në vitin 2021, *Njësia e monitorimit të mediave sociale e EU EOM-së vëzhgoi disa postime të fushatës së LDK-së, PDK-së dhe LVV-së që u drejtoheshin votuesve me aftësi të kufizuara në Facebook dhe Instagram. KQZ-ja përfshiu gjuhën e shenjave në mesazhet për edukimin e votuesve dhe vazhdoi të sigurojë fletëvotimet me prekje, si dhe broshurat me kandidatët në alfabetin Braille. Për herë të parë në shumë qendra votimi kishte në dispozicion kabinë më të ulët të votimit për personat me karrocë invalidësh ose për të moshuarit. Megjithatë, gjatë raundit të parë, vëzhguesit e BE-së raportuan se vetëm në 67 për qind të vendvotimeve të vizituara ishte siguruar qasja për votuesit me aftësi të kufizuara të lëvizjes ndërsa në 78 për qind të tyre hapësirat ishin të përshtatshme për votuesit në karrocë invalidësh. Gjatë raundit të dytë, ekipet e BE-së vunë në dukje se vetëm 65 për qind e vendvotimeve të vëzhguara ishin të qasshme për votuesit me aftësi të kufizuara të lëvizjes, ndërsa struktura e vendvotimit ishte e përshtatshme për votuesit në karrocë invalidësh në rreth 85 për qind të vendvotimeve të vizituara. Fletëvotimet me prekje nuk ishin në dispozicion në 33 për qind të qendrave të votimit të vizituara⁸⁵.*

Ndërsa nga Deklarata Preliminare e Organizatës për Monitorimin e Zgjedhjeve në Kosovë, Demokracia në veprim, lidhur me zgjedhjet e parakohshme nacionale të vitit 2021 është përfunduar se *Pavarësisht se në Kosovë jetojnë mbi 200,000 persona me aftësi të kufizuara, pjesëmarrja e tyre në aktivitete zgjedhore mbetet tej et e ulët, meqë vetëm 247 persona morën pjesë në aktivitetet e monitoruara zgjedhore në shtatë qendrat kryesore. Mungesa e*

⁸⁵ Bashkimi Evropian, *Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve nga BE në Kosovë, Zgjedhjet Komunale 2021 Raporti përfundimtar Faqe 37 nga 81*, <https://www.eods.eu/library/Final%20Report%202021%20EOM%20Kosovo%20municipal%20elections%20-%20ALBANIAN.pdf>.

infrastrukturës së duhur për qasje të personave me aftësi të kufizuara ka vështirësuar ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E KOSOVËS 14 shkurt, 2021 dhe më tej pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet zgjedhore meqenëse në 31% të aktivitetëve nuk është garantuar qasje adekuate për këtë kategori. Në këtë f ushatë zgjedhore në asnjë rast nuk ka pasur persona me aftësi të kufizuar të cilët i janë adresuar elektoratit ⁸⁶.

Nuk ka ndonjë statistikë zyrtare, se sa persona me aftësi të kufizuar janë të punësuar në institucionet publike, por numri është relativisht i ulët dhe në shumë institucione as nuk përmbushet kriteri ligjor i punësimit në çdo të 50 -tin të punësuar⁸⁷. Në vitin e fundit ka lëvizje për adresimin më të madh të përfaqësimit të PAK në institucione publike, p.sh. vitin e fundit, nga institucionet publike janë hapur diku rreth shtate (7) konkurse për persona me aftësi të kufizuar.

Sa i përket lirisë së asociimit, kryesisht personat me aftësi të kufizuar janë të asocuar rreth dhe në organizatat e personave me aftësi të kufizuar sipas llojit të aftësisë së kufizuar, t ë cilat avokojnë dhe llojnë për avancimin e personave me aftësi të kufizuar për pjesëmarrje në jetën publike dhe politike dhe për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. Disa nga organizatat e personave me aftësi të kufizuar janë anëtarë dhe pjesë marrës në organizatat e tyre simotra në nivel rajonal dhe ndërkombëtarë.

V.2.1 Pjesëmarrjen në votime dhe pjesëmarrja në zgjedhje

Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes i ka garantuar edhe kushte tuta ashtu siç e kemi përshkruar në pjesën për kushtetutën. Të njëjtat garanci i jep edhe Ligji për Zgjedhje të përgjithshme, me të cilin garantohet e drejta për të votuar dhe për tu zgjedhur për *Çdo qytetar i Kosovës pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm. Barabarësia në ushtrimin e të drejtës për të votuar dhe për të hedhur numër të barabartë të votave, është e garantuar. Njësoj është garantuara liria dhe fshehtësia e votës , Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim.*

Ligji ka definuar edhe Votimin e Personave me Aftësi të Kufizuar " *Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta*" (VPNV), që do të thotë marrëveshjet e bëra dhe procedurat e ndjekura për ata votues me të drejtë vote në Kosovë të cilët nuk mund të votojnë personalisht në VV - në në të cilën janë caktuar për Ditën e Zgjedhjeve. Në sigurimin e garancisë nga Neni 89 [E Drejta e Votës dhe Fshehtësia e Votës], paragrafi 5, ka rregulluar mënyrën e votimit të

⁸⁶ Demokracia ne Veprim, Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës e Kosovës, DEKLARATË PRELIMINARE, 14 shkurt, 2021, https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2021/02/FINAL_Deklarata-preliminare-p%C3%ABr-zgjedhjet-e-parakohshme-p%C3%ABr-Kuvendin-e-Kosov%C3%ABs.pdf.

⁸⁷ Majlinda Ibrahim, Gazeta KOHA, në një hulumtim të bërë në vitin 2022, ka gjetur se Ministrinë, që numërojnë 31.520 persona, sipas listës së pagave, kanë të punësuar vetëm 45 persona me aftësi të kufizuara. Gjashtë ministri nuk kanë të punësuar asnjë person me aftësi të kufizuar. Në 37 komunat e Kosovës, që në listën e pagave numërojnë 42.924 persona, janë të punësuar vetëm 43 persona me aftësi të kufizuara. Në 19 komuna nuk kanë asnjë person me aftësi të kufizuar të punësuar si nëpunës civilë. <https://www.koha.net/arberi/328814/ministrine-shkelin-liqjin-per-punesimin-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara/?fbclid=IwAR3YYcfV0ElqraoN-W2pNd4dOd-EeI5SBvFRKTSblyDSR1CoBPQD7CGdH0>

personave me aftësi të kufizuar i/e cila ka pengese në votimin e rregullt, duke konstatuar se *Votuesi i cili është me aftësi të kufizuar në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin dhe/ose është analfabet mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi nëse ai kërkon një ndihmë të tillë. P ersoni i tillë e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV-së ose vëzhgues i akredituar*

Kreu XV [Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta], i Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, iu ka referuar edhe një herë komunitetit të personave me aftësi të kufizuar dhe ka garantuar dhe rregulluar pjesëmarrjen e tyre në procesin e votimit, duke numëruar:

a) votuesit me të drejtë vote të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotimin e zakonshëm për shkak të paaftësisë fizike, mjekësore ose çfarëdo paaftësie tjetër;

b) votuesit me të drejtë vote me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion: votuesit në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara veçanërisht për të moshuarit, personat me aftësi të zvogëluar mendore në institucionet e kujdesit shëndetësor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit; ose

c) votimi në rrethana të veçanta: votuesit që jetojnë në bashkësitë, të cilat, për shkak të zhvendosjes nga vendi afër vendvotimit të tyre të rregullt ose për shkaqe sigurie, nuk mund të votojnë në vendvotimin e tyre të caktuar. Për këtë lloj votimi kërkohet miratimi nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve.

KQZ, nën autoritetin e këtij ligji, Neni 59 është organi qendror për menaxhimin e zgjedhjeve në Kosovë dhe garantimin e secilit person për shfrytëzimin e të drejtës së votës. Gjatë zbatimit të mandatit të vet KQZ -ja, përveç tjerash:.... *krijon procedura të përshtatshme dhe ndërmer aktivitete për të garantuar se të gjithë personat me aftësi të kufizuara mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit dhe të marrin pjesë tërësisht në procesin zgjedhor në Kosovë.*

KQZ, publikon jo më vonë se 40 ditë para zgjedhjeve lokacionet e sakta të të gjitha qendrave të votimit dhe sigurohet që *Vendvotimet (VV) të jenë në vend të qashtëm për të mundësuar votuesit të formojnë dhe të qëndrojnë në rresht dhe duhet, kur është e mundshme, të kenë qasje të niveluar që personat me aftësi të kufizuara të kenë hyrje dhe dalje të papenguar. VV-të kanë ndriçim adekuat dhe mbrojtje nga aksidentet elementare* Neni 83 *[Lokacionet e Vendvotimeve dhe Qendrave të Votimit]*.

KQZ, gjithashtu *në kohë të duhur, organizon dhe sponsorizon fushatën për edukimin e votuesve. Ajo shpërndan nëpër të gjithë vendin, sipas Ligjit për përdorim të gjuhëve, informatat për: a) procedurat e votimit; dhe b) të drejtat e votuesve dhe procedurat për mbrojtjen e tyre, përfshire edhe mekanizmat për ankesë. Gjatë bërjes së fushatës për edukimin e votuesve, Sekretariati i KQZ -ja i kushton vëmendje të veçantë votuesve në viset rurale, me aftësi të kufizuara dhe analfabet,* Neni 107.

KQZ-ja gjithashtu është përgjegjëse për *Transmetimi i informatave për votuesit,* Neni 108. *KQZ-ja përgatit material të përshtatshëm për transmetim në radio dhe televizion për*

informimin e publikut për procesin zgjedhor në Kosovë. Materiali informues i përgatitur nga KQZ-ja për emetim në televizion përmban mënyrë për transmetimin simultan për njerëzit me dëgjim të dëmtuar në gjuhën adekuate për nevojat e grupeve gjuhësore të cilat shërbehen nga transmetuesi.

LIGJI NR. 03/L-072 PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS -rregullon zgjedhjet për kuvendet komunale dhe kryetar të komunave në nivel lokal. Jep garanci të njëjta sikur ligji për zgjedhje të përgjithshme.

Gjendja faktike: Organizatat e personave me aftësi të kufizuar theksojnë se me gjithë garancitë ligjore për pjesëmarrje në zgjedhje dhe votime, megjithëse disa nga kërkesat ligjore janë plotësuar si p.sh, shabllonet për votim për personat e verbër, materialet për votim të siguruara, lejimi i asistencës në votim, situata e personave me aftësi të kufizuar për të marrë pjesë efektive në zgjedhje dhe në votime është tejte e vështirë. Sa i përket pjesëmarrjes efektive në votime në kuptim të së drejtës për tu zgjedhur mungon një kuotë pjesëmarrje për personat me aftësi të kufizuar në listat zgjedhore të partive politike dhe me gjithë të drejtën për tu përfshirë në listë kjo është vetëm në bazë të vullnetit e jo oblig uese dhe si rezultat kemi shumë pak persona me aftësi të kufizuar, të zgjedhur. Ndërsa, sa i përket pjesëmarrjes në zgjedhje dhe në ditën e votimeve, vazhdojnë të ketë barriera në mungesë të qasjes fizike, fushatat e KQZ bëhen në gjuhën e shenjave, ndërsa fushatat e kandidatëve nuk behen⁸⁸.

V.2.2 Përfaqësimi në institucione publike- nuk ka pengesa ligjore në kuptim të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuar në institucionet publike. Gjithsesi, ky përfaqësim është shumë i ulët në krahasim me numrin e personave me aftësi të kufizuar, si rezultat edhe i mungesës së qasjes dhe mungesës së politikave adekuate për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën publike dhe në përfaqësimin në institucionet publike.

V.2.3 Pjesëmarrje në organizata joqeveritare dhe përfaqësim i organizatave; Ligji Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare Neni 4, garanton të drejtën e secilit person për tu asociuar dhe për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.

Njëjtë garanton të drejtën për të mos u asociuar kundër vullnetit të tij, përfshirë edhe mbrojtjen nga diskriminimi si rezultat i vendimit për asociim apo për të mos u asociuar.

Gjithashtu, ligji garanton edhe të drejtën e çdo personit të themelojë organizatë joqeveritare në pajtim me kushtet dhe rrethanat e përcaktuara me ligj.

Kjo e drejte ushtrohet në mënyrë të barabartë, neni 5. *OJQ ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me parimin e respektimit, të mbrojtjes dhe të zbatimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuara në Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare në fuqi. Politikat, legjislacioni, si dhe aktivitetet lidhur me OJQ -në, zbatohen në përputhje me bazat e përcaktuara me Ligjin përkatës për mbrojtjen nga diskriminimi.*

⁸⁸ Grupi punues legjislativ për pjesëmarrje, datë 12.06.2023.

V.2.4 Përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale)– nuk ka dispozita që në mënyrë eksplicite e rregullojnë këtë çështje, gjithsesi nuk është ndaluar me asnjë dispozitë dhe lidhur me përfaqësimin vlejné parimet dhe dispozitat për barabarësinë dhe mos diskriminimin. Megjithatë, nuk mund të identifikohen veprime apo masa afirmative për të nxitur dhe përkrahur pjesëmarrjen edhe pse ka pasur raste simbolike të përkrahjes.

Përderisa, përfaqësimi i PAK në nivele kombëtare është relativisht më i mirë, në raport me nivelet e tjera, meqenëse OPAK –ët gjatë punës së tyre avokuese kanë marrë pjesë në një sërë mekanizmash përfaqësimi apo kanë pasur mundësi që të ndikojnë në mekanizmat institucional përmes avokimit, përfaqësimi në nivele ndërkombëtare dhe rajonale nuk është i mirë, megjithëse ka pasur raste p.sh., kur qeveria ka financuar për pjesëmarrjen e PAK në forume të ndryshme për aftësinë e kufizuar.

Mekanizmi më i rëndësishëm i përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuar në nivel nacional është Këshilli i Personave me Aftësi të Kufizuar (KPAK).

KPAK është themeluar nga Kryeministri i Kosovës, si organ këshillëdhënës dhe orientues mbi përcaktimin e prioriteteve dhe politikave në fushën e aftësisë së Kufizuar me qëllim të monitorimit dhe zbatimit të politikave nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, si organ kryesor i përhershëm këshillues i cili koordinon bashkëpunimin e Qev erisë me organizatat për persona me aftësi të kufizuara lidhur me të drejtat dhe çështjet e aftësisë së kufizuar.

Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar përbëhet nga gjithsejtë 14 anëtarë dhe kryesohet nga Zëvendës Kryeministri/ja, ndërsa në cilësinë e Zëvendës kryesuesit është Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, ndërsa anëtarët janë në cilësinë e Zv. Ministrave nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe infrastrukturës. Në cilësinë e anëtarëve janë edhe organizatat e personave me aftësi të kufizuar: HANDIKOS, HANDICAP KOSOVA, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve, Shoqata e të Verbërve të Kosovës, Sindrom Down Kosova, Shoqata Autizmi.

VI. KUADRI INSTITUCIONAL PËR QASJE DHE PJESËMARRJE NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE

Qasje

Kuadri institucional, përgjegjës për garantimin e sigurimit dhe respektimit të qasshmërisë në kuptim të mjedisit fizik, transportit publik, informacionit dhe komunikimit, përfshirë shërbimet e TV publik dhe Internetin dhe shërbimet publike, është i shpërndarë në sektorë të ndryshëm institucional në formën e përgjegjësive për zbatimin e kornizës ligjore pronare të së cilës janë ato institucione.

Mbrojtja institucionale ligjore për zbatimin dhe respektimin e të drejtave kushtetuese nga Kapitulli II [Te Drejtat dhe Liritë Themelore], është Gjykata Kushtetuese e Kosovës e cila është autoriteti përfundimtarë për interpretimin e Kushtetues dhe pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese mund ti shqyrtojë kërkesat e parashtruara nga individët dhe personat juridik që pretendojnë se autoritetet publike (organet shtetërore, autoritetet administrative, gjykatat, etj.) i kanë shkelur potencialisht të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë⁸⁹.

Gjithashtu, mbrojtje ligjore e të drejtave të njeriut garantohet edhe përmes gjykatave të rregullta. P.sh. në vitin 2022 dhe 2023, Gjykata Themelore në Prishtinë dhe ajo në Vushtrri kanë nxjerr dy aktgjykime me të cilat është konstatuar diskriminimi mbi bazën e aftësisë së kufizuar për qasje, mosdhënie të akomodimit të arsyeshëm.

Në aspektin e organeve të administratës në nivel nacional, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe Ministrinë përkatëse, ajo e transportit, infrastrukturës, financave, mirëqenies, shëndetësisë, arsimit, planifikimit hapësinor etj., janë përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës sipas fushave që mbulojnë.

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM), e ka emëruar një zyrtar që i adreson çështjet e personave me aftësi të kufizuar dhe gjithashtu e administron KPAK, duke qenë se Drejtori i ZQM është edhe Zëvendës Kryesues i KPAK. Ndërsa, në nivel të ministrive, në disa nga ato, janë të emëruar zyrtarët për të drejtët e njeriut të cilët në portofolin e detyrime adresojnë edhe aftësinë e kufizuar.

Nuk ka ndonjë infrastrukturë institucionale nacionale që fokus të posaçëm ta ketë aftësinë e kufizuar. Gjithsesi, OPAK -et, deklarojnë se në të shumtën e rasteve kanë mundësi të takojnë zyrtarët përgjegjës nëpër ministrinë përkatëse për të diskutuar çështjet me rëndësi.

Në nivel lokal, gjithashtu çështjet e personave me aftësi të kufizuar adresohen përmes drejtorive komunale përkatëse dhe zyrtarëve për të drejtat e njeriut, të barazisë gjinore dhe në disa Komuna ku janë funksionale edhe përmes Komiteteve Konsultative për personat me aftësi të kufizuar të cilët veprojnë qoftë në kuadër të administratës së komunës, qoftë në kuadër të asambleve komunale.

Pjesëmarrje në jetën publike dhe politike

Njësoj si në rastin e qasjes, edhe tek përfshirja nuk ka ndonjë infrastrukturë institucionale formale që adreson kryesisht pjesëmarrjen. Kjo mbetet nën autoritetin e organeve përgjegjëse për zbatim në funksion të ligjit përkatës.

Personat me aftësi të kufizuara nuk janë të përfshirë në mënyrë të përhershme në organet apo institucionet që zbatojnë dhe monitorojnë procesin zgjedhor në Kosovë. Gjithsesi, ka

⁸⁹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Udhëzuesi për parashtrimin e kërkesave individuale KI, f.2, https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/07/gjkk_udhezuesi_per_kerkesa_ki_shq_26.07.2023.pdf

raste kur ata janë konsultuar nga KQZ-ja, lidhur me organizimin e votimit për persona me aftësi të kufizuar por nuk ka evidence nëse PAK janë përfshirë në procesin për monitorimin e zgjedhjeve.

OPAK-ët janë anëtarë të rregullt të KPAK dhe secili OPAK që përfaqëson një grup të personave me aftësi të kufizuar sipas llojit, e ka përfaqësuesin e vet në KPAK.

Gjithashtu, PAK kanë qenë të përfshirë në grupe punuese për hartimin e legjislacionit që e adreson aftësinë e kufizuar. Por, nuk ka ndonjë evidence nëse PAK kanë qenë të përfshirë në grupe punuese për hartimin e legjislacionit që trajton fusha tjera të cilat prekin edhe të drejtat dhe interesat e tyre .

VII. FORMA E PËRMBLEDHUR E ANALIZËS SË KORNIZËS LIGJORE PËR QASJE DHE PJES ËMARRJE NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE

Qasja

Niveli i qeverisjes	Ligji / rregullorja ekzistuese (përfshirë Kushtetutën dhe akte të tjera: strategjitë, politikat, udhëzimet)	Zgjidhjet që ofrohen në legjislacion	Mospërputhje me detyrimet që parashikon neni përkatës i Konventës së KB	Ndryshimet e nevojshme/ të domosdoshme për të garantuar përputhshmërinë
Nivel nacional	KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702	Neni 21 Parimet e Përgjithshme Garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut Neni 22 Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare Neni 24 Barazia para Ligjit Barabarësisë para ligjit dhe baza t e diskriminimit Neni 53 Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut Në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.	Nuk ka	Përfshirja e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDKPAK), në nenin 22, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës
		Neni 54 Garantimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave		
Nivel Nacional	LIGJI Nr. 04/L – 092 PËR PERSONAT E VERBËR https://qzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2837&fbclid=IwAR0HvY6Xivi_GBHM7hiU_bëëZ4nllkmiN8CO5jFel1rUë9DoLaëcGBu6a7kq	Neni 4 Mbrojtja Nga diskriminimi dhe barabarësia Neni 6 Lirimi nga taksat dhe tatimi Neni 7 Të ardhurat dhe beneficionet Neni 8 Strehimi Neni 9 Kujdesi shëndetësor Neni 10 Edukimi dhe Arsimimi Neni 11 Qasja në informacion Neni 12 Rehabilitimi Neni 13 Udhëtimi Neni 14 Shpenzimet e energjisë elektrike dhe telefonit Neni 15 Përfitimet dhe të drejtat tjera Projektet e infrastrukturës; rregullimi i territorit në sigurimin e përshtatjeve	Dispozita të pjeshme në secilin element të qasjes në sektor Nuk e rregullojnë në tërësi mjedisin fizik, transportin, informimin dhe komunikimin dhe shërbimet publike Nuk ka dispozita lidhur me shërbimet e ofruara nga media publike (TV, radio) dhe Interneti as teknologjia informative	Ligji për statusin dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara Sektorët e fokusuar në këtë analizë (mjedisi fizik, transporti, informimi-komunikimi dhe shërbimet publike) të adresohen si pjesë e legjislacionit të aplikuar që adreson fushën përkatëse në përgjithësi Ose Ligje të veçanta për secilën fushë. Ligji veçantë për financimin e organizatave të personave me aftësi të kufizuar / vijë buxhetore për OPAK që ofrojnë shërbime për PAK në mungesë të shërbimeve të shtetit. Rregullore / akt juridik për operatorët privat autobusët dhe taksitë, në nivel nacional dhe lokal.

<p>Nivel Nacional</p>	<p>Ligji Nr. 05/L -067 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E PERSONAVE PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK</p> <p>https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12554</p>	<p>Neni 4 Mbrojtja</p> <p>Diskriminimi dhe barabarësia</p> <p>Neni 6 Liria e të shprehurit dhe mendimit, si dhe qasja në informacion</p> <p>Neni 7 Kompensimi</p> <p>Neni 8 Kujdestari personal</p> <p>Neni 9 Fondet për pagesa të kompensimit</p> <p>Neni 10 Lirimi nga taksat dhe tatimi</p> <p>Neni 12 Arsimimi</p> <p>Neni 13 Kujdesi shëndetësor</p> <p>Neni 14 Shpenzimet e energjisë elektrike</p> <p>Neni 15 Udhëtimi</p> <p>Neni 16 Përkujdesja për strehim</p>	<p>Dispozita të pjesshme në secilin element të qasjes në sektor</p> <p>Nuk e rregullojnë në tërësi mjedisin fizik, transportin, informimin dhe komunikimin dhe shërbimet publike</p> <p>Nuk ka dispozita lidhur me shërbimet e ofruara nga media publike(TV, radio) dhe Interneti as teknologjia informative</p>	<p>Ligj i për statusin dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara</p> <p>Hartimi i rregulloreve në nivel nacional dhe lokal, me aneks lista kontrolluese me indikatorë për vlerësim e qasjes në ndërtesa publike dhe ato me destinim për publikun</p> <p>Rregullore / akt juridik për operatoret privat autobusët dhe taksitë, në nivel nacional dhe lokal</p> <p>Ndryshim-plotësim i RREGULLORE (QRK) NR. 07 /2017 PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN, PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT VLERËSUES DHE PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR NJOHJEN E STATUSIT DHE TË DREJTAVE TË PERSONAVE PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK</p> <p>Ligj i veçante për financimin e organizatave të personave me aftësi të kufizuar / vijë buxhetore për OPAK që ofrojnë shërbime për PAK në mungese të shërbimeve të shtetit</p>
<p>Nivel Nacional</p>	<p>LIGJI Nr. 03/L -019 PËR AFTËSIMIN,</p>	<p>Neni 3 Përkufizimet</p>	<p>Dispozitat e këtij ligji zbatohen pjesërisht</p>	<p>Plotësim-ndryshimi i këtij ligji.</p>
<p>Nivel Nacional</p>	<p>RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA</p> <p>https://qzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2620</p> <p>LIGJI NR. 05/L -078PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-019PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA,</p> <p>https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2620</p>	<p>Definimi i Përshtatshmërisë së mjedisit</p> <p>Definimi i Mjetet ndihmëse</p> <p>Neni 5 Diskriminimi</p> <p>Neni 8 Aftësimi, Riaftësimi Profesional dhe Aftësimi i Personave me Aftësi të Kufizuar</p> <p>Neni 10 Politikat qeveritare për aftësimin profesional</p> <p>Neni 12 Punësimi në tregun e hapur të punës</p>	<p>ose nuk zbatohen</p> <p>Nuk e trajtojnë fushën në tërësi</p>	<p>Punësimi të trajtohet me një ligj të veçantë për ta ezauruar plotësisht kërkesat për akomodimin të arsyeshëm në vendin e punës.</p> <p>Ligji që trajton aftësimin dhe riaftësimin profesional në tërësi me kërkesat e fushës.</p> <p>Plotësim ndryshimi edhe i Ligjit për shërbyesit civil</p>
<p>Nivel Nationale</p>	<p>LIGJI NR. 04/L -131 PËR SKEMAT PENSIONALE TË FINANCUARA NGA SHTETI</p> <p>https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9517</p>	<p>Neni 4 Të drejtat e përcaktuara me këtë ligj</p> <p>E drejta në pension të aftësisë së kufizuar;</p> <p>Neni 9 Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension të pa aftësisë të përhershme</p>	<p>Ka mospërputhje</p>	<p>Plotësim-ndryshimi i këtij ligji</p>

		<i>Pensioni i aftësisë së kufizuar u paguhet shtetasve të Kosovës, që posedojnë dokumentet e identifikimit, prej moshës (18) deri (65) vjeç.</i>		
<i>Nivel Nacional</i>	<i>LIGJI Nr. 05/L -021 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI</i> https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924	<i>Neni 1 Qëllimi</i> <i>Bazat e diskriminimit (aftësia e kufizuar është bazë)</i> <i>Neni 2 Fushëveprimi,</i> <i>Zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat</i> <i>Neni 4 Llojet e trajtimit të pabarabartë</i> <i>Mosdhënia e një përshatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat e tyre specifike</i> <i>Neni 10 Promovimi dhe bashkëpunimi për avancimin e të drejtave të njeriut</i> <i>Neni 11 Mekanizmat institucional për mbrojtje nga diskriminimi në Ministri dhe Komuna</i>	<i>Nuk janë identifikuar mospërputhje</i> <i>Sfida në zbatimin e ligjit</i>	<i>Nuk ka nevojë për ndryshim.</i> <i>Aktualisht ligji është në vlerësim (ex-post)</i>
<i>Nivel Nacional dhe nivel lokal</i>	<i>UDHËZIMI ADMINISTRATIV -Nr. 33/2007 PËR KUSHTET TEKNIKE TË</i>	<i>Neni 5 Fushëveprimi -objektet ndërtimore publike dhe administrative dhe objektet ndërtimore të banimit dhe</i>	<i>E ka trajtuar qasjen më shumë se çdo akt ligjor tjetër megjithatë kufizohet</i>	<i>Duhet të shndërrohet në ligj ose fushat specifike të këtij sektori duhet të përfshihen në legjisllacionin</i>
	<i>OBJEKTEVE NDËRTIMORE PËR QASJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA.</i> <i>(Shfuqizuar me Vendim të QRK, Nr. 02/50 të datës 23.12.2021) - (Mbetet në fuqi me Vendimi të QRK, Nr. 05/56 të datës 26.01.2022</i> https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7480	<i>banesore -afariste.</i> <i>Neni 6 Kushtet për përdorimin e mjeteve ndihmese</i> <i>Neni 7 Elementet obliguese për qasje</i> <i>Neni 8 Sipërfaqja taktore</i> <i>Neni 9 Elementet për qasje në nivele të ndryshme</i> <i>Neni 15 Elementet e qasjes për jetese të pavarur</i> <i>Neni 44 Realizimi i obliguar i elementeve për qasje</i> <i>Neni 51 Modernizimi i qasjeve në objekte ndërtimore</i> <i>Neni 54 Përmbajtja obliguese e projektit</i> <i>Neni 36 Elementet për qasje në komunikacionin publik</i> <i>Neni 35 Plani orientues për lëvizje në ndërtesa</i> <i>Neni 5 Objektet ndërtimore publike dhe administrative janë</i> <i>SHTOJCA -paraqitja e fotografive me shenja të qasjes për kushtet e përdorimit të elementeve ndihmëse për</i>	<i>në fushëveprimin nga neni 5</i> <i>Ka dispozita edhe për pjesën tjetër infrastrukturore por faktikisht mbetet në funksion të fushëveprimit</i> <i>Është e kufizuar mbi bazën e ligjit për ndërtim me çka e zvogëlon shumë shtrirjen e kërkesave</i> <i>Dispozitat nuk janë të organizuara mirë</i>	<i>që e trajton secilën fushë veç e veç</i> <i>Ligji për adresimin e qasjes në mjedisin fizik</i> <i>Ligji për adresimin e qasjes në transportin publik</i> <i>Ligji për adresimin e qasjes në informim, komunikim, media, internet dhe TIK</i> <i>Ligji për adresimin e qasjes në shërbime publike</i> <i>Akt ligjor për aplikimin e Parimeve të Dizajnit Universal për të gjitha fushat e qasjes (përdorimin universal dhe dizajni universal)</i>

Nivel Nacional dhe nivel lokal	RREGULLORE QRK Nr. 15/2014 PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7480	qasje Neni 2 Fushëveprimi për të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe atë lokal. Neni 4 Koordinimi në ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave Neni 6 Procedura për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave për personat e shurdhër Neni 7 Procedura për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave për institucionet publike Neni 8 Financimi Neni 9 Trajnimet dhe certifikimi Neni 17 Publikimi dhe informimi Neni 19: Përgjegjësia për zbatim të rregullores bie tek ZQM	Nuk ka	Duhet të shndërrohet në Ligj për gjuhën e shenjave dhe ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave
Nivel Nacional	STRATEGJIA NACIONALE PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2013-2023	Strategjia e re në zhvillim	NA	NA

Pjesëmarrja në jetën publike dhe politike

Niveli i qeverisjes	Ligji / rregullorja ekzistuese (përfshirë Kushtetutën dhe akte të tjera: strategjitë, politikat, udhëzimet)	Zgjidhjet që ofrohen në legjislacion	Mospërputhje me detyrimet që parashikon neni përkatës i Konventës së KB	Ndryshimet e nevojshme / të domosdoshme për të garantuar përputhshmërinë
Nivel nacional	KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	Neni 44 Liria e Asociimit Lirinë për të marrë pjesë në një organizatë dhe lirinë për të themeluar një organizatë Neni 45 Të Drejta të Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes Garantimi i lirisë për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur. Garantimi i barabarësisë, lirisë dhe fshehtësisë së votës. Garantimi i pjesëmarrjes në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.	Nuk ka	KDPAK duhet të përfshihet në nenin 22, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës
Nivel Nacional	LIGJI NR. 08/L-228 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS https://qzk.rks-gov.net/ActDetail	Neni 4 Parimet Themelore Barabarësia në ushtrimin e të drejtës së votës pa diskriminim Neni 3 Përkufizime Për Votimin e Personave me Nevoja të	E ka trajtuar relativisht mirë të drejtën për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur Disa aspekte të ligjit nuk janë	Rregullimi i terminologjisë së përshtatshme për përkufizimin e personave me aftësi të kufizuara Ndryshim/plotësimi i Ligjit për partitë politike - për përfshirjen e veprimeve afirmativë lidhur me pjesëmarrjen e PAK në lista

	aspx?ActID=2544	<p>Veçanta" (VPNV)⁹⁰</p> <p>Neni 59 KQZ</p> <p>Autoriteti për menaxhimin e procesit zgjedhor</p> <p>Neni 83 Lokacionet e Vendvotimeve dhe Qendrat e Vendvotimeve</p> <p>Neni 89 E Drejta e Votës dhe Fshehtësia e Votës</p> <p>Neni 99 Dispozitat e Përgjithshme, KREU XV/ Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta</p> <p>Neni 107 Informimin e votuesve dhe mediave</p> <p>Neni 108 Transmetimi i informatave për votuesit</p>	<p>zbatuar në tërësi, p.sh. Krijimi i qasjes së plotë pa barriera fizike për pjesëmarrjen e personave me dëmtime fizike</p>	<p>zgjedhore</p> <p>KQZ-Listat zgjedhore një kuotë për pjesëmarrje të PAK</p> <p>Krijimi i një mekanizmi monitorues për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e përfshirjes së PAK në jetën publike dhe politike (ndoshta akt ligjor).</p>
Niveli Lokal	<p>LIGJI NR. 03/L-072 PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS</p> <p>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2549</p>	<p>Neni 3 Parimet themelore</p> <p>Barabarësia në ushtrimin e të drejtës për të votuar pa diskriminim</p> <p>Dispozitat tjera të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vlejné edhe për zgjedhjet lokale.</p>	<p>Njësoj si në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme</p>	<p>Njësoj si në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme</p>
	<p>LIGJI NR. 06/L-043 PËR LIRINË E ASOCIIMIT NË ORGANIZATA JOQEVERITARE</p> <p>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=19055</p>	<p>Neni 4: Liria e Asociimit</p> <p>Neni 5: [Trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi]</p>	<p>E ka adresuar lirinë e asociimit në mënyrë të përgjithshme</p>	<p>Ndryshim-plotësim i ligjit aktual për qëllim të specifikimit të karakterit dhe statusit të OPAK-ve si OJQ</p> <p>Ligji veçantë për financimin e OPAK-ve për pjesëmarrje në nivel rajonale dhe ndërkombëtare.</p>

⁹⁰ Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme, iu referohet kryesisht si persona me nevoja të veçanta, në disa raste edhe me aftësi të kufizuara. Terminologjia adekuate ashtu sikur e përcakton edhe Kushtetuta e Kosovës, është Person me Aftësi të Kufizuara.

VIII. PËRFUNDIME/KONKLUZIONE

Raporti i analizës së kornizës ligjore të Kosovës në raport me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Rekomandi met e Komitetet të OKB -së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në fushën e qasjes dhe të pjesëmarrjes publike dhe politike, pasqyron gjendjen aktuale juridike me të cilën materializohen çështjet e aftësisë së kufizuar në Kosovë.

Analiza e kornizës ligjore të Kosovës është fokusuar në legjisllacionin/aktet juridike të cilat e kanë adresuar fushat e kërkimit në raport me nenin 9 dhe 29 të KDPAK dhe rekomandimeve të Komitetit të OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar me fokus të posaçëm për fushën e qasjes në mjedisin publik, transportin, informacionin dhe komunikimin, TIK dhe në fushën e pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike, në pjesëmarrjen në votime dhe zgjedhje, përfaqësimin në institucione publike, përfaqësimin në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtare dhe asociimin. Kjo analizë përfshin kontekstin e kornizës aktuale legjislative dhe asaj institucionale.

Hulumtimi ishte përqendruar në analizën e asaj se çka ofron legjisllacioni i Kosovës, përfshirë Kushtetutën e Kosovës, në raport me KDPAK, kërkesave të nenit 9 për qasjen dhe të nenit 29 për pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike të personave me aftësi të kufizuar dhe bazuar në materializimin e këtyre kërkesave në baze të rekomandimeve të Komitetit të OKB-se për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në fushat e shënjestruara.

Me qëllim të arritjes së përfundimeve krahasuese është zgjedhur legjisllacioni specifik që ka adresuar aftësinë e kufizuar sipas llojit të aftësisë së kufizuar, pa përfshirë se dispozita ligjore që adresojnë aftësinë e kufizuar gjendet edhe në legjisllacionin tjetër në Kosovë e që nuk kanë qenë subjekt i këtij hulumtimi.

Nga analiza e bërë është e qartë se Kosova e njeh të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të marrë pjesë aktive në jetën publike dhe politike sepse që nga akti më i lartë Kushtetues janë dhënë garanci të përgjithshme për barabarësinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut pa diskriminim edhe në bazë të aftësisë së kufizuar dhe atë mbi bazën e standardeve ndërkombëtare dhe jurisprudencën Evropiane, megjithatë situata juridike/legjisllacioni tjetër dhe ajo faktike në realizimin e këtyre të drejtave nuk krijojnë garanci në respektimin e plotë të kërkesave kushtetuese dhe nuk i afrohet standardeve të kërkuara të Konventës. Sepse, me gjithë ekzistencën e një baze ligjore e cila është e mangët, moszbatimin e dispozitave ligjore në praktike, sfidat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuar nuk krijojnë kushtet optimale për pjesëmarrje të barabarte dhe pa barriera.

Megjithëse ka një numër aktesh ligjore që e adresojnë aftësinë e kufizuar në përgjithësi dhe qasjen dhe pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike në veçanti, asnjë nga këto akte nuk i kanë adresuar në tërësi fushat e analizës. Dhe kjo vlen vetëm për pjesën e normimit të fushës, përderisa nuk është hulumtuar zbatimi edhe pse në raport ka ndonjë opinion të dhënë lidhur me zbatimin. Ky përfundim del nga analiza krahasuese, ku është gjetur se megjithëse aktet e ndryshme ligjore e kanë adresuar fushën e qasjes asnjë nga aktet ligjore nuk e ka adresuar në mënyrë të plotë as mjedisin fizik, as transportin, informimin dhe komunikimin apo shërbimet publike. Dispozitat ligjore në këtë fushë janë

të shpërndara nëpër akte ligjore, janë të fragmentuara dhe janë jo të plota për ta trajtuar një komponent në tërë strukturën e saj. Dispozita ligjore më të përqendruara i gjejmë në fushën e pjesëmarrjes publike, kjo është relevante vetëm për komponentin e pjesëmarrjes në votime ku ka dispozita ligjore të veçanta që i referohen pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në procesin zgjedhor dhe zgjidhje ligjore për këtë çështje, ndërsa pjesa tjetër e kësaj fushe si përfaqësimi në institucione publike, përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale është adresuar pak ose fare në dispozitat ligjore, përderisa liria e asociimit është trajtuar në përgjithësi pa e përcaktuar aftësinë e kufizuar.

Ndërsa, kuadri institucional për adresimin e fushave specifike të aftësisë së kufizuar është i ndërtuar mbi bazën e autoritetet të vënë sipas ligjit specifik të fushës dhe është më shumë deklarativ se sa operativ. Përfunduar KPAK në nivel qendror dhe Komitetet Konsultative në nivel lokal të cilat merren me avancimin e politikave në fushën e aftësisë së kufizuar dhe në raste të veçanta edhe me monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e aftësisë së kufizuar, në institucionet tjera aftësia e kufizuar është pjesë e portfolies në mes të përgjegjësive tjera.

Megjithëse, në vitet e fundit si rezultat i avokimit të vazhdueshëm të OPAK-ve dhe posaçërisht në Vitin 2022, që ishte shpallur Vit i Personave me Aftësi të Kufizuar, janë parë përpjekje më të prekshme për të adresuar fusha me interes për aftësinë e kufizuar, megjithatë përpjekjet nuk janë të strukturuar për ta adresuar aftësinë e kufizuar në përgjithësi dhe në veçanti qasja dhe pjesëmarrja është adresuar pak ose fare apo vetëm adhoc.

Nga të gjeturat mund të përfundojmë se legjislacioni aktual në Kosovë nuk është në harmoni me Konventën e KB, as nga ana formale e as nga ana materiale, ndaj rekomandohet që institucionet e Kosovës në një afat sa më të shkurtër të rishikojnë tërë kornizën legjislative të aftësisë së kufizuar dhe të harmonizojnë atë me standardet e kërkuara të KDPAK, duke filluar me adresimin e politikave të qasjes si parakushte për pjesëmarrje efektive në jetën publike dhe realizimin e të drejtave tjera për personat me aftësi të kufizuar. Një rishikim strukturor i tërë infrastrukturës ligjore (kornizës legjislative dhe institucionale), i paraprirë nga një analizë e vlerësimit nga një sistem i vlerësimit kombëtare për standardet e aftësisë së kufizuar, është i domosdoshëm me qëllim të përputhshmërisë dhe harmonizimit me KDPAK.

Një pako me rekomandime specifike për secilën fushë për intervenim, do të përgatitet gjatë procesit të avokimit për këtë raport.

REFERENCAT

1. Andrea Broderick, *of rights and obligations: the birth of accessibility*, <https://ëëë.tandfonline.com/doi/full/10.1080/13642987.2019.1634556#:~:text=Accessibility%20refers%20to%20the%20inclusive,serices%2C%20as%20%20%20as%20facilities>
2. ADRF, *Methodology for Drafting the Analysis of Compliance of the Legislative Framework with the UN Convention on the Rights of Persons with Disabilities*
3. BE dhe HANDIKOS, *Raport hulumtues, STANDARDET NDËRKOMBËTARE MBI ÇËSHTJET E AFTËSISË SË KUFIZUAR KU QËNDRON KOSOVA? Vlerësim i legjislacionit të Kosovës në lidhje me çështjet e aftësisë së kufizuar në raport me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*,
http://handi-kos.org/ëp-content/uploads/2004/05/Report_SHQ-29_04_20_95548.pdf
4. Bashkimi Evropian, *Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve nga BE në Kosovë, Zgjedhjet Komunale 2021 Raporti përfundimtar*,
<https://ëëë.eods.eu/library/Final%20Report%202021%20EOM%20Kosovo%20municipal%20elections%20-%20ALBANIAN.pdf>
5. Council of Europe, Anna Lawson, *Accessibility of information, technologies and communication for persons with disabilities Contribution to the Council of Europe Strategy on the Rights of Persons with Disabilities*,
<https://rm.coe.int/final-study-accessibility-of-information/168072b420> .
6. Demokracia ne Veprim, *Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës e Kosovës, DEKLARATË PRELIMINARE*,
https://kdi-kosova.org/ëp-content/uploads/2021/02/FINAL_Deklarata-preliminare-p%C3%ABr-zgjedhjet-e-parakohshme-p%C3%ABr-Kuvendin-e-Kosov%C3%ABs.pdf
7. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, *Udhëzuesi për parashtrimin e kërkesave individuale* Kl, https://gjk-ks.org/ëp-content/uploads/2023/07/gjkk_udhezuesi_per_kerkesa_ki_shq_26.07.2023.pdf
8. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, *versioni ne anglisht* <https://ëëë.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf> dhe *versioni shqip* https://ëëë.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf
9. Kushtetuta e Republikës së Koso vës, *është shpallur me 15 qershor 2008, dhe pesë (5) amendamente Kushtetuese*, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>
10. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, *publikimi në facebook*,
<https://ëëë.facebook.com/albini2017/videos/622740806631112/>
11. Ligji Nr. 04/L -092 për Persona të Verbër, *hyrë në fuqi 18 Korrik 2012, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 20 / 18 KORRIK 2012, PRISHTINË*, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2837> .

12.Ligji Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, hyrë në fuqi 16 Qershor 2016, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 19 / 16 QERSHOR 2016, PRISHTINË, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12554>

13.Ligji Nr. 03/L-19 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar, hyrë në fuqi me 25 Janar 2009, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 47 / 25 JANAR 2009, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2620>

14.LIGJI NR. 05/L -078 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L -019PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, Neni3.

15.Ligji NR. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme ne Republikën e Kosovës, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 14 / 3 KORRIK 2023, PRISHTINË,

16.Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, hyrë në fuqi me 15 Qershor 2008, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 32 / 15 QERSHOR 2008,

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2549>

17.Ligji Nr. 06/L-43 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, hyrë në fuqi me 24 prill 2019, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 11 / 24 PRILL 2019, PRISHTINË, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=19055>

18.Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, hyrë në fuqi me 26 qershor 2015, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 16 / 26 qershor 2015, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>

19.RREGULLORE QRK - Nr. 03/2017 PËR MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI NË QEVERI DHE KOMUNA, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>

20.UDHËZIMI ADMINISTRATIV-Nr. 33/2007 PËR KUSHTET TEKNIKE TË OBJEKTEVE NDËRTIMORE PËR QASJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA. (Shfuqizuar me Vendim të QRK, Nr. 02/50 të datës 23.12.2021), <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7480>.

21.RREGULLORE QRK Nr. 15/2014 PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10363>.

22.Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023, <https://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=41058>.

23.Qeveria e Kosovës, Vendimi Nr. 08/46 date 30.11.2022, <https://handi-kos.org/vendimi-i-qeverise/>

24. UN/ UN Human Rights Office of the High Commissioner THE CONVENTION ON THE RIGHTS OF PERSONS WITH DISABILITIES/ Training Guide/ Professional Training Series/MODULE 2 – A SHORT INTRODUCTION TO THE CONVENTION,
https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/CRPD_TrainingGuide_PTS19_EN_Accessible.pdf.

25. Gjykata Kushtetuese e Kosovës/ Njoftim për vendim në rastin KO 207/22, 01 Gusht 2023/ <https://gjk-ks.org/njoftim-per-vendim-ne-rastin-ko-207-22/>

26. UN/CRDP/C/GC/2/ Committee on the Rights of Persons with Disabilities Eleventh session/ General comment No. 2 (2014)/ 22 May 2014,
file:///C:/Users/FastTech/Downloads/CRPD_C_GC_2-EN.pdf

27. UN/CRPD/C/GC/7/Distr.: General 9 November 2018/Committee on the Rights of Persons with Disabilities/General comment No. 7 (2018) on the participation of persons with disabilities, including children with disabilities, through their representative organizations, in the implementation and monitoring of the Convention,
file:///C:/Users/FastTech/Downloads/CRPD_C_GC_7-EN.pdf

28. Union of Equality- Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021–2030
[file:///C:/Users/FastTech/Downloads/KE0221257ENN_002%20p roof%20%20\(5\).pdf](file:///C:/Users/FastTech/Downloads/KE0221257ENN_002%20p roof%20%20(5).pdf).

29. Sustainable Development Goals (SDG),
<https://social.desa.un.org/issues/disability/sustainable-development-goals-sdgs-and-disability>

30. Technical Note on Accessibility Fact Sheet 3: Accessibility in the Transportation Sector of Operations, f. 16,
<https://thedocs.worldbank.org/en/doc/31614367f4fd3ec4dfce873759b7761b-0320012022/original/EBG-TECHNICAL-NOTE-PART-3-3.pdf>

31. World Bank Group, Social Development, Country Profile Kosova, Disability Inclusion,
<https://documents1.worldbank.org/curated/en/099446001262338576/pdf/IDU0c94b5e380a97e043fe0ae7004c952e7e18e6.pdf>

Grupi punues legjislativ për qasje.
Grupi punues legjislativ për pjesëmarrje.

Linqe në internet:

<https://social.desa.un.org/issues/disability/crpd/convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities-crpd#Fulltext>

<https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=738&langId=en&pubId=8376&furtherPubs=yes>.

<https://ec.europa.eu/social/main.jsp?langId=en&catId=1612&eventsId=2111&furtherEvents=yes>

https://www.un.org/disabilities/documents/sdgs/disability_inclusive_sdgs.pdf.

[http://handi-kos.org/ëp-
content/uploads/2004/03/strategjia_nacionale_finale_per_shtyp_3_gjuhet_bardh_e_zi_88013-2.pdf](http://handi-kos.org/ëp-content/uploads/2004/03/strategjia_nacionale_finale_per_shtyp_3_gjuhet_bardh_e_zi_88013-2.pdf).



Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA) dhe as konsorciumit SMART Balkans.

